

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

UDHËZUES

për autoritetet zbatuese mjedisore
lidhur me përcaktimin dhe zbatimin
e ndëshkimeve me gjoba

Prishtinë, Janar 2019

Autor: Ahmet Kasumi M.A.

Tabela e Përmbajtjes

SHKURTESAT DHE AKRONIMET 4
FJALORI 5
HYRJE 6
QËLLIMI I UDHËZUESIT 7

1. STRUKTURA INSTITUCIONALE 8
1.1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) 8
1.2. Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit 9
1.3. Divizioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave 9
1.4. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës 10
1.5. Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH) 10
1.6. Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore 11
1.7. Komunat 11
1.8. Policia e Kosovës 12
1.9. Gjykatat 12
1.10. Përmbaruesit Privatë 12

2. KORNIZA LIGJORE 14
2.1. Ligji Mbrojtjen e Mjedisit 14
2.2. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës 14
2.3. Ligji për Mbeturina 14
2.4. Ligji për Kimikate 15
2.5. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis 16
2.6. Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare 16
2.7. Ligji për Produkte Biocide 17
2.8. Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma 17
2.9. Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja 18
2.10. Ligji për Ujërat e Kosovës 18
2.11. Ligji për Ndërtim 19
2.12. Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje 19
2.13. Ligji për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi 20
2.14. Legjislacioni i Inspektoratit 20

3. PROCEDURA E ZBATIMIT TË NDËSHKIMEVE ME GJOBA 21
3.1. Procedura e përgjithshme administrative 21
3.2. Procedura për kundërvajtje 21
3.4. Raporti zyrtar për kontrollin inspektues 22
3.5. Vendimi për ndalimin e përkohshëm të aktiviteteve 23
3.6. Raporti zyrtar për riinspektim 23
3.7. Vendimi për lejimin e serishëm të aktivitetit 23
3.8. Vendimi për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë 23
3.9. Vendimi i Komisionit për refuzimin e ankesës kundër vendimit për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë 24
3.10. Propozimi për përmbarimin nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm 25
3.11. Kërkesa për zhvillim të procedurës së kundërvajtjes në Gjykatë 25

4. LISTA KONTROLLUESE 27
4.1. Përcaktimi i shkeljes ligjore dhe dispozitave përkatëse inspektive dhe ndëshkuese 27

4.2. Përpilimi i Raportit Zyrtar (kontrollimi inspektues) 27
4.3. Nxjerrja e Vendimit për ndalimin përkohësisht të aktiviteteve 27
4.4. Përpilimi i Raportit Zyrtar për riinspektim 28
4.5. Nxjerrja e Vendimit për lejimin e serishëm të aktiviteteve 28
4.6. Nxjerrja e Vendimit për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë 28
4.7. Vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e ankesës 29
4.8. Propozimi për përmbarim 29
4.9. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes 29

5. PROCEDURAT E SHQIPTIMIT TE NDESHKIMEVE ME GJOBE 31
5.1. Skema e procedurës se shqiptimit të ndëshkimeve me gjobë 31
5.2. Procedura e Vendimit për ndëshkimin me gjobë deri në përmbarim 33
5.3. Procedura e ndëshkimit me gjobë - sipas konfliktit administrativ 34
5.4. Procedura para Gjykatës së Kundërvajtjes 35

SHTOJCË 2: Raport zyrtar (kontrollimi inspektues) 37
SHTOJCË 3: Vendim për ndalimin e përkohshëm të aktivitetit 39
SHTOJCË 4: Raport zyrtar (Riinspektim) 40
SHTOJCË 5: Vendim për lejimin e aktivitetit 41
SHTOJCË 6: Vendim për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë 42
SHTOJCË 7: Vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e ankesës 44
SHTOJCË 8: Propozimi për përmbarim/Urdhri përmbarues 45
SHTOJCË 9: Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes 48
SHTOJCË 10: DISPOZITAT MBIKËQYRËSE DHE NDËSHKUESE 50
Ligji Mbrojtjen e Mjedisit Ne 50
Ligji për Mbrojtjen e Natyrës 51
Ligji për Mbeturina 56
Dispozitat ndëshkuese 56
Ligji për kimikate 62
Dispozitat mbikëqyrëse 62
Dispozitat ndëshkuese 62
Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis 66
Dispozitat mbikëqyrëse 66
Dispozitat ndëshkuese 66
Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare 66
Ligji për Produkte Biocide 68
Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma 69
Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja 70
Ligji për Ujërat e Kosovës 71
Ligji për Ndërtim 73
Ligji për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi 73

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit i Kosovës
ARPL	Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
BE	Bashkimi Evropian
DÇAGJTH	Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore
DK	Divizioni për Kundërvajtje
GJKK	Gjykata Kushtetuese e Kosovës
GJS	Gjykata Supreme
GJA	Gjykata e Apelit
GJTH	Gjykata Themelore
IMM	Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
KE	Komisioni Evropian
LK	Ligji për Kundërvajtje
LKA	Ligji për Konfliktet Administrative
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
LPK	Ligji për Procedurën Kontestimore
LPP	Ligji për Procedurën Përmbarimore
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
PK	Policia e Kosovës
PKMZSA	Plani i Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit

FJALORI

Akt administrativ	Manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike.
Arsyetim	Pjesë e aktit administrativ që i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ.
Dispozitiv	Pjesa urdhëruese e aktit administrativ që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm.
Dokument i besueshëm	Dokument mbi bazën e të cilit caktohet realizimi i kërkesës në të holla.
Dokument përmbarues	Dokument mbi bazën e të cilit fillohet procedura e përmbarimit.
Gjobë	Sanksion kundërvajtës.
Interes publik	Interes material ose jomaterial i ligjshëm dhe i drejtë në dobi të qytetarëve.
Inspektor	Person zyrtar me autorizime dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara me ligj.
Inspektorat	Organ shtetëror në nivel lokal dhe qendror i cili ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e mbikëqyrjes inspektive në fushën e kompetencës.
Konflikt administrativ	Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.
Konfiskim	Konfiskimi i përhershëm i pasurisë, të urdhëruar me vendim të formës së prerë nga Gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin në fuqi.

HYRJE

Në kuadër të modulit të trajnimit "Fuqizimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit mjedisor", është paraparë edhe një Udhëzues praktik për zyrtarët mjedisor, në të cilin paraqiten në mënyre skematike të gjitha veprimet e inspektorëve me rastin e përcaktimit dhe zbatimit të ndëshkimeve me gjoba.

Udhëzuesi është një dokument praktik i organizuar në atë mënyrë që zyrtarëve mjedisorë t'iu ofrojë informacione të mjaftueshme për punën e tyre.

Udhëzuesi jep një përshkrim të shkurtë të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal me kompetenca për zbatimin e legjislacionit mjedisor. Këtu në rend të parë mendohet në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Inspektoratin e Mbrojtjes së Mjedisit, Agjencionin e Mbrojtjes së Mjedisit dhe institucionet tjera zbatuese të ligjit.

Udhëzuesi ofron kornizën e ligjeve të zbatueshme nga fusha e mjedisit, të cilat përcaktojnë detyra dhe përgjegjësi për institucionet mjedisore. Theks i veçantë me këtë rast i është dhënë ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, ujërave dhe ndërtimit.

Pjesa e tretë e Udhëzuesit e shpjegon procedurën e zbatimit të ndëshkimeve me gjoba. Këtu paraqiten në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet procedurale që i paraprijnë vendimit për ndëshkimin me gjobë, deri në përmbarimin e këtij vendimi.

Vijon pastaj lista kontrolluese e veprimeve e cila përmban listën e dokumenteve të nevojshme për zbatimin e ndëshkimeve me gjoba. Këtu çdo veprim procedural referohet edhe në format e bashkangjitura në shtojca të Udhëzuesit.

Në fund të Udhëzuesit paraqiten shtojcat që kanë të bëjnë me raportet, vendimet, propozimet dhe kërkesat si dhe të gjitha dispozitat ndëshkuese të legjislacionit në mënyrë që zyrtarët të kenë më të lehtë të gjejnë bazën ligjore të shkeljeve si dhe të arsyetojnë më lehtë vendimet e tyre.

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi u dedikohet zyrtarëve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, zyrtarëve të Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit, Inspektorëve mjedisor komunal, si dhe të gjithë zyrtarëve të cilat kanë kompetenca në zbatimin e legjislacionit mjedisor në Republikën e Kosovës.

Udhëzuesi është i konceptuar në atë mënyrë që inspektorëve t'iu japë informacione të mjaftueshme për bazën ligjore mbi të cilën shqiptohen ndëshkimet me gjoba si dhe t'iu ofrojë veprimet procedurale të cilat duhet t'i ndjekin me rastin e shqiptimit të atyre ndëshkimeve.

Për më tepër, Udhëzuesi parasheh mostrat të cilat mund të përdoren me rastin e përcaktimit dhe hartimit të ndëshkimeve, si p.sh. raporte zyrtare, vendime, kërkesa, propozime etj.

Ky dokument ofron një tablo të të gjitha dispozitave të aplikueshme ligjore nga fusha e mjedisit, ujërave, ndërtimit dhe banimit që korrespondojnë me autorizimet inspektuese të inspektorëve.

Po ashtu, dokumenti përmban edhe dispozitat ligjore për mbikëqyrjen inspektuese në mënyrë që inspektorët të jenë në dijeni për bazën ligjore të autorizimeve të tyre si inspektorë.

1. STRUKTURA INSTITUCIONALE

Në vijim do të jepet një përshkrim i shkurtër i organizimit institucional në nivel qendror dhe lokal të organeve që kanë në kompetencë mbrojtjen e mjedisit dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor.

1.1. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Detyrat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (këtu e tutje: MMPH) janë përcaktuar me Shtojcën "13", të Rregullores së Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Sipas kësaj rregulloreje, **MMPH është kompetente për zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm nga fusha e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit e banimit.** Për këtë qëllim, MMPH ka ngritur njësi organizative për ushtrimin sa më efikas të mandatit dhe përgjegjësive të saj.

MMPH, në mes tjerash, ka në kompetencë bashkërendimin e aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes së mjedisit, përcaktimin e normave, standardeve dhe udhëzimeve nga fusha e mbrojtjes së mjedisit si dhe mbikëqyrjen e tyre. MMPH po ashtu mbikëqyre procesin e inspektimit dhe shërbimet tjera.

Rregullimi i brendshëm i MMPH-së është bërë me Rregulloren (QRK) Nr.05/2017 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas kësaj rregulloreje, MMPH në përbërjen e saj ka departamentet në vijim:

- Departamentin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave
- Institutin për Planifikim Hapësinor
- Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit:
- Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore
- Departamentin për inspektim të mjedisit, natyrës, ujërave, ndërtimit dhe planifikimit hapësinor
- Departamentin për Shpronësim
- Departamentin për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave
- Departamentin Ligjor, dhe
- Departamentin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.

Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për bashkërendimin e inspektimit për lëminë e mbrojtjes së mjedisit dhe natyrës, ujërave, ndërtimit dhe planifikimit hapësinor.

Departamenti për Inspektim të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor ndahet në:

- Divizionin për Inspektim të Mbrojtjes së Mjedisit, Natyrës dhe Ujërave, dhe

- Divizionin për Inspektim të Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtim.

1.2. Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit

Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit (këtu e tutje: Inspektorati) është organ ekzekutiv në kuadër të MMPH-së i themeluar me Ligjin Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit. Sipas këtij Ligji, **Inspektorati ushtron mbikëqyrjen inspektive dhe kontrollin përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e legjislacionit që ka të bëjë me fushën e mbrojtjes së mjedisit.**

Inspektorati ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e tij në mbrojtje të mjedisit, duke harmonizuar aktivitetin e tij me legjislacionin Evropian, përkatësisht kriteret minimale për inspektimet mjedisore në shtetet anëtare. Inspektorati mbikëqyrjen inspektive e ushtron përmes kontrollit dhe inspektimit në zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Inspektorati në përbërjen e tij ka njësitë në vijim:

- Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit;
- Inspektorati i mbrojtjes së natyrës;
- Inspektorati i ujërave;
- Inspektorati i planifikimit hapësinor dhe urbanistik, dhe
- Inspektorati i ndërtimit.

1.3. Divizioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave

Rregullorja (QRK) Nr.05/2017 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mes tjerash rregullon edhe kompetencat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave. Sipas nenit 36 të kësaj rregulloreje, Divizioni për Shqyrtimin e Parashtresave dhe Ankesave është organi i shkallës së dytë në procedurën administrative në kuadër të MMPH-së.

Divizioni kompetencë kryesore ka shqyrtimin ligjor të të gjitha parashtresave dhe ankesave të personave fizik dhe juridik, ndaj akteve administrative të shkallës së parë të organeve komunale, sipas afateve ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, Divizioni shqyrton dhe nxjerrë e akte administrative individuale dhe kolektive për të gjitha ankimimet administrative, qofshin ato në formë të kërkesave për rishqyrtim apo ankesa, të cilat ndërlidhen me realizimin e të drejtave të përcaktuara me ligjet dhe aktet nënligjore.

Ndër të tjera, Divizioni shqyrton dhe njofton menjëherë palët kërkuese, se ankesa është pranuar dhe se procedimi administrativ lidhur me ankesën e parashtruar ka filluar, si dhe regjistron të gjitha parashtresat dhe ankesat në një libër të veçantë.

1.4. Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit i Kosovës (këtu e tutje: Agjencioni) është themeluar me Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e mjedisit. Detyrat kryesore të Agjencionit konsistojnë në sigurimin e informacioneve mjedisore dhe zhvillimin dhe koordinimin e sistemit unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit. Këtë detyrë Agjencioni e bën përmes vendosjes dhe mbajtjes së qendrave referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit, zhvillimin e procedurave për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin si dhe kryerjen e punëve profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit.

Detyrat e lartshënuara të Agjencionit kanë për qëllim mbështetjen shkencore dhe kërkimore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Përkitazi me organizimin e Agjencionit, këtu duhet shtuar se në mars të vitit 2014, MMPH ka nxjerrë Rregulloren Nr. 03/2014 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencionit për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës. Kjo rregullore ka paraparë përgjegjësitë për drejtoritë dhe institutet përkatëse të Agjencionit të cilat kanë rëndësi të posaçme në menaxhimin e gjendjes së mjedisit në Kosovë. E rëndësisë së veçantë mbetet sidomos Drejtoria për gjendjen e mjedisit e cila në kompetencë të saj ka sistemin e informimit për mjedisin dhe raportimin.

1.5. Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH)

Instituti për Planifikim Hapësinor është themeluar me Rregulloren (QRK) Nr.05/2017 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas kësaj rregulloreje, Instituti në përbërjen e saj ka divizionet në vijim:

- Divizioni për Planifikim dhe Bashkëpunim
- Divizioni për Hulumtim dhe Vlerësim, dhe
- Divizioni i GIS-it për Planifikim Hapësinor.

Detyrat kryesore të Institutit konsistojnë në hartimin dhe revidimin e dokumenteve të Planit Hapësinor të Kosovës, Hartës Zonale të Kosovës dhe Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta, duke përfshirë edhe dokumentet tjera që ndërlidhen dhe ndihmojnë sektorin e planifikimit hapësinor. Instituti ofron këshilla dhe asistencë profesionale/teknike për komunat, në hartimin e Planeve Zhvillimore dhe Hartave Zonale Komunale. Përveç këtyre detyrave, Instituti ka edhe detyra dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me rregulloren e lartcekur.

1.6. Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore është themeluar me Rregulloren (QRK) Nr.05/2017 për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas kësaj rregulloreje, Autoriteti në përbërjen e saj ka divizionet në vijim:

- Divizioni për Menaxhimin e Resurseve Ujore,
- Divizioni për Planifikimin e Resurseve Ujore dhe
- Divizioni për Pagesat ujore dhe Projekte.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit konsistojnë në hartimin e planeve për menaxhimin e pellgjeve lumore dhe udhëheqjen e proceduarave deri në miratimin e planit, përfshirë kontrollin e zbatimit dhe përditësimin e planit.

Autoriteti bën përcaktimin e vijës së plotave, vijës së zonave erozive, kufijve të pellgjeve lumore dhe zbatimi i procedurave përkatëse deri në nxjerrjen e vendimeve përfundimtare. Po ashtu, Autoriteti përgatitë bazën profesionale dhe zbaton procedurat për ruajtje dhe mbrojtje të resurseve ujore në nivel të pellgut lumor, si dhe mban regjistra për zonat erozive, zonat sanitare, zonat të ndjeshme, koncesione, shpronësime. Përveç këtyre detyrave, Autoriteti ka edhe detyra dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me rregulloren e lartcekur.

1.7. Komunat

Ndonëse MMPH ka rol parësor në zhvillimin e kushteve ligjore për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë, megjithatë janë komunat ato që kanë përgjegjësinë institucionale në mbrojtjen e mjedisit në territorin e tyre. Së këndejmi, Ligji për Vetëqeverisjen lokale, komunën e parasheh si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, të përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore. Rrjedhimisht, komunave në Kosovë i janë dhënë kompetenca të gjëra në të gjitha fushat e organizimit të qytetarëve.

Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, në mes tjerash, edhe për sa i përket mbrojtjes së mjedisit lokal, ofrimit dhe mirëmbajtjes së shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehjes lokale. Nga kjo rrjedhë se autoriteti i komunave në zbatimin e legjislacionit mjedisor është shumë i madh dhe atë kryesisht përmes inspektorëve komunal të mjedisit.

Për ushtrimin e detyrave të mbikëqyrjes dhe kontrollit, inspektorati komunal organizohet në kuadër të drejtorive komunale sipas fushave përkatëse.

Inspektorati komunal i mbrojtjes së mjedisit ushtron detyrat dhe përgjegjësitë përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në zbatimin e ligjeve në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe natyrës. Për më tepër, inspektorati komunal ushtron mbikëqyrjen në zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara me lejet komunale mjedisore, lejet ujore dhe të mbrojtjes së natyrës, të lëshuara nga komuna.

1.8. Policia e Kosovës

Një tjetër institucion që ka rol mbështetës në zbatimin e legjislacionit mjedisor është Policia e Kosovës. Policia funksionon nën autoritetin e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Roli i Policisë së Kosovës përkitazi me mbrojtjen e mjedisit vjen në shprehje kryesisht në rolin e saj si autoritet kompetent për mbështetjen e Inspektoratit, inspektorët komunal të mjedisit dhe zyrtarëve tjerë të autorizuar.

Sipas Ligjit për Policinë, me kërkesë të institucioneve të qeverisjes qendrore ose lokale, policia është e autorizuar t'ju ofroj ndihmë në kryerjen e detyrave publike, kur ka arsye për të besuar se siguria e personit ose e personave që kryejnë detyra publike mund të rrezikohet për shkak të rezistimit të mundshëm ndaj veprimeve të tyre.

Roli i Policisë në lidhje me zbatimin e legjislacionit mjedisor bëhet më i rëndësishëm sa i përket shqiptimit të taksave dhe gjobave. Në përgjithësi, roli i Policisë vlerësohet lartë për bashkëpunimin e saj me inspektorët. Ajo çfarë do të duhej të përmirësohej në lidhje me rolin e Policisë është përcaktimi i saktë i detyrave dhe përgjegjësive të saj në lidhje me mbështetjen e institucioneve lokale.

1.9. Gjykatat

Gjykatat si instancë e fundit luajnë rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e legjislacionit në përgjithësi dhe legjislacionit mjedisor në veçanti, kjo ngase të gjitha vendimet e organeve kundërvajtëse i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

Gjykatat e nivelit themelor që në kompetencë të tyre kanë çështjet mjedisore janë Divizioni për Kundërvajtje i Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Departamenti Administrativ i Gjykatës Themelore të Prishtinës. Kompetencat e këtyre gjykatave rregullohen me Ligjin për Gjykatat Nr. 03/L – 199 si dhe me ligjet tjera procedurale.

1.10. Përmbaruesit Privatë

Ligji për Procedurën Përmbarimore parasheh mundësinë e zhvillimit të procedurës përmbarimore në bazë të titullit të përmbarimit dhe dokumenteve të besueshme. Ky ligj parasheh *inter alia* edhe aspektet tjera, procedurat e përshtatshme të përmbarimit, gjobat për debitorët, kërkesën që kreditori të sigurojë adresën e debitorit, etj.

Edhe pse aktualisht organet kundërvajtëse në masë të ultë kanë proceduar rastet e ndëshkimeve me gjoba te përmbaruesit privat, duhet theksuar se vendimet e lëshuara në procedurë administrative pas marrjes së formës së prerë i kanë atributet e dokumentit përmbarues (titull ekzekutiv) në kuptim të Ligjit për procedurën përmbarimore.

Rrjedhimisht, organet kundërvajtëse mund të fillojnë procedurën e ekzekutimit të dhunshëm të vendimeve për ndëshkimet me gjoba.

2. KORNIZA LIGJORE

2.1. Ligji Mbrojtjen e Mjedisit

Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2009. Synimi i këtij ligji ishte dhe mbetet zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, deri sa qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.

Megjithëse fushëveprimi i këtij ligji është i gjerë, për qëllime të këtij Moduli duhet potencuar se mbrojtja e mjedisit dhe zvogëlimi i rrezikut për ndotjen e mjedisit mbesin prioritete kryesore. Natyrisht, mbrojtja e mjedisit nuk mund të paramendohet pa një administrim efikas të mbeturinave. Prandaj ky ligj përkitazi me mbeturinat bën referencë në Ligjin për mbeturinat. Ligji përcakton organet përgjegjëse për administrimin e mbrojtjes së mjedisit, dhe këtu në rend të parë i referohet Qeverisë, MMPH-së dhe komunave të Kosovës.

2.2. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e natyrës ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2010. Ligji ka për qëllim mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë dhe veçanërisht mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. **Autoritete kompetente për mbrojtjen e natyrës janë MMPH, komunat dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës**.

Dispozitat përkitazi me mbikëqyrjen inspektuese i hasim në nenin 162 të ligjit. Sipas këtij neni, mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e kryen inspektori i mbrojtjes së natyrës, në kuadër të inspektoratit mjedisor

Dispozitat përkitazi me ndëshkimet rregullohen me kreun XIV, **përkatësisht nenet 164, 165, 166, 167, 168, 169 dhe 170. Këto dispozita parashohin gjobat nga dhjetëmijë (10.000) gjer në dyzetmijë (40.000) Euro** për kundërvajtje personit juridik nëse kryejnë ndërhyrjen ose veprimin i cili mund të asgjësoj ose shkaktoj dëm të madh ose të përhershëm në zonën e rëndësishme ekologjike.

2.3. Ligji për Mbeturina

Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2012. Ligji ka për qëllim evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimin e komponentëve të përdorshme nga mbeturinat, zhvillimin e qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore,

parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut si dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Fushëveprimi i këtij ligji konsiston në menaxhimin e mbeturinave, planet për menaxhimin e mjedisit, të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyra dhe kushtet e mbledhjes së mbeturinave, transportit, trajtimit, përpunimit, magazinimit dhe deponimit përfundimtar, importin, eksportin dhe transitin e mbeturinave, monitorimin, sistemin informativ dhe financimin.

Në kapitullin XII ligji i parasheh dispozitat përkitazi me mbikëqyrjen administrative dhe inspektive, ashtu që i ngarkon Inspektoratin e MMPH-së dhe inspektoratet komunale me rolin e mbikëqyrjes inspektive për zbatimin e dispozitave të Ligjit për mbeturina, dhe dispozitave tjera të nxjerra në bazë të këtij ligji.

Autorizimet e inspektorit parashihen me nenin 63 të këtij Ligji, kurse me nenin 64 rregullohet çështja e raportit dhe procesverbalit të inspektorit. Për inspektimet e kryera Inspektori mban procesverbalin sipas procedurës së paraparë me Ligjin për mbrojtjen e mjedisit, përkatësisht nenet 81, 82, 83, 84 dhe 85.

Autorizimet e inspektorit komunal parashihen me nenin 66 të Ligjit, sipas të cilit inspektori mbikëqyr dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës përkatëse.

2.4. Ligji për Kimikate

Ligji Nr. 04/L-197 për Kimikate ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2014. Ligji ka për qëllim menaxhimin e drejtë të kimikateve të rrezikshme, mbrojtjen dhe zvogëlimin e rrezikut të mundshëm nga kimikatet, të cilat mund të ndikojnë dhe shkaktojnë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Fushëveprimi i këtij ligji konsiston në përcaktimin e kushteve për vendosjen në treg të substancave dhe përzierjeve të rrezikshme si dhe përcaktimin e mënyrës së kontrollimit të tyre; përcaktimin dhe vlerësimin e rreziqeve që mund të ndikojnë dëmshëm në shëndetin e njeriut dhe mjedisin; shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve për qarkullimin, trajtimin dhe përdorimin e kimikateve dhe; mbajtjen e regjistrit të kimikateve; regjistrin e personave fizik dhe juridik që tregtojnë dhe përdorin kimikatet; kushtet për klasifikimin, etiketimin, paketimin, importin, eksportin dhe transitin e kimikateve të rrezikshme si dhe përgjegjësitë e autoritetit kompetent për zbatimin dhe monitorimin e këtij ligji. Ligji si autoritet kompetent për administrimin e kimikateve e përcakton MMPH-në.

Mbikëqyrja dhe inspektimi parashihen me dispozitat e Kreut XII të këtij ligji. Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra nga ky ligj e bën Ministria, kurse mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bënë Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit dhe inspektorati fito sanitar.

Detyrat dhe autorizimet e inspektorit parashihen me nenet 83 dhe 84, kurse kundërvajtjet dhe masat ndëshkuese parashihen me Kreun XIII, përkatësisht me nenin 89 të ligjit.

2.5. Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ligji Nr. 03/ L-214 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2010. Ligji ka për qëllim parandalimin ose zvogëlimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Ligji ka në fushëveprim vlerësimin e ndikimit në mjedis, identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin në mënyrë të duhur të rrethanave të secilit rast individual, efektet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projekteve në njeriun, botën bimore dhe shtazore; në tokë, ujë, ajër, klimë dhe peizazh; të mirat materiale dhe trashëgiminë kulturore dhe ndikimet e ndërsjella të elementeve të theksuara.

MMPH është autoriteti kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, përderisa komunat janë autoritete për mjedis për zonën e të cilave synohet të realizohet projekti i propozuar, si dhe autoritetet të cilat përpilojnë dhe mirëmbajnë të dhënat lidhur me gjendjen e mjedisit në Kosovë dhe mbi emisionet në mjedis.

Mbikëqyrjen administrative dhe inspektive parashihet me nenin 33 përkatësisht nenin 34. Sipas këtyre neneve, për zbatimin e dispozitave të Ligjit dhe akteve nënligjore është përgjegjëse MMPH, kurse inspektorati i mbrojtjes së mjedisit është përgjegjëse për të gjitha inspektimet e projektit dhe zbatimit të dispozitave të këtij ligji. Dispozitat ndëshkuese për shkeljen e ligjit parashihen me nenin 38.

2.6. Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare

Ligji Nr. 03/ L-104 për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2010. Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë realizimin e normave dhe konventave ndërkombëtare nga lëmi i rrezatimit jo-jonizues, jonizues dhe siguria nukleare; të sigurojë krijimin i një mjedisi të shëndoshë i cili i përballon ndotjet dhe shpenzimet për mbrojtje nga rrezatimi jonizues dhe siguria nukleare dhe të jetë në pajtim me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik; të krijojë kompetenca dhe detyrime të autoriteteve publike të cilat janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të standardeve të tilla, dhe të definojë të drejta dhe detyrime ndaj personave dhe ndërmarrjeve që preken nga aktivitetet e tilla ose interesat që promovojnë një mjedis të shëndetshëm në Kosovë.

Ligji ka fushëveprim përcaktimin e masave mbrojtjes të jetës dhe shëndetit të njerëzve si dhe mjedisit nga ndikimi i dëmshëm i rrezatimit jo-jonizues dhe jonizues, masat e sigurisë nukleare gjatë të gjitha veprimeve lidhur me aktivitetet nukleare, mbeturinave radioaktive dhe mbikëqyrjes gjatë zbatimit të masave.

Ligji si autoritet kompetent për mbikëqyrjen dhe zbatimin e tij parasheh Agjencinë për Mbrojtjen nga Rrezatimet i Kosovës (AMRK) që mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet. **Neni 50 i këtij ligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij ligji, e që e ngarkon Inspektoratet përkatëse.** Dispozitat ndëshkuese, përkatësisht veprat penale dhe kundërvajtjet parashihen në Kreun XI.

2.7. Ligji për Produkte Biocide

Ligji Nr. 03/ L-119 për Produktet Biocide ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2009. Qëllimi i këtij ligji është që të caktojë dhe të rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdorën për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë të mbrojë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit.

Mbikëqyrja parashihet me nenin 54 të këtij ligji i cili e përcakton MMPH si përgjegjëse për mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj, informimin dhe shkëmbimin e informatave. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj e bëjnë inspektoratet: mjedisorë, sanitarë dhe fito sanitar. Ndërsa, inspektorët inspektojnë hapësirat, objektet, aparaturat, pajisjet dhe dokumentacionin. Dispozitat ndëshkuese parashihen me nenin 58.

2.8. Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma

Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga zhurma ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2007. Qëllimi i këtij ligji është shmangia, parandalimi ose zvogëlimi në baza prioritare i efekteve të dëmshme, duke përfshirë edhe bezdisjen si rezultat i ekspozimit të zhurmës në mjedis. Ligji për më tepër ka krijuar bazën për krijimin e masave për zvogëlimin e zhurmës së emituar nga burimet e mëdha, veçanërisht ato rrugore, hekurudhore, ajrore, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineria mobile dhe burimet tjera të ndotjes dhe bezdisjes së mjedisit nga zhurma.

Ligji për mbrojtjen nga zhurma zbatohet për zhurmën mjedisore ndaj të cilës njerëzit ekspozohen në zonat e ndërtuara, "zonat e veçanta të planit hapësinor", në parqet publike ose zonat tjera të qeta të aglomerateve, zonat e qeta në vendet e hapura, afër shkollave, spitaleve, zonave dhe ndërtesave të tjera të ndjeshme ndaj zhurmës.

Sipas nenin 22 të këtij ligji, mbikëqyrjen, për aplikimin e tij dhe të akteve plotësuese normative që dalin nga ky ligj, e kryejnë inspektorët e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe inspektorët komunal të mjedisit. Përderisa, mbikëqyrja për dispozitat e këtij ligji të cilat i dedikohen zhurmës në hapësira ku punohet, ku gjatë procesit të punës shkaktohet zhurmë si dhe në dispozitat e këtij ligji të cilat i dedikohen qarkullimit të makinave, mjeteve transportuese, pajisjeve dhe aparateve, fuqisë së zërimit që emitohet nga to, në kushte të përcaktuara, kryhet nga inspektoret e inspektoratit të mjedisit. Dispozitat ndëshkuese përkitazi me mbrojtjen nga zhurma parashihen në kreun VII.

2.9. Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

Ligji Nr. 03/ L-160 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja ka hyrë në fuqi në muajin shkurt të vitit 2010. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi dhe garantimi i drejtës së qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit. **Monitorimi dhe mbikëqyrja inspektive rregullohen me nenin 33 dhe 34.** Sipas këtyre MMPH siguron monitorimin e përhershëm të cilësisë së ajrit dhe ndikimin në mjedis dhe shëndetin e popullatës. Ndërsa mbikëqyrja inspektive i është besuar inspektoratit. Dispozitat ndëshkuese parashihen me nenin 38.

2.10. Ligji për Ujërat e Kosovës

Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës ka hyrë në fuqi në mars të vitit 2013. Ligji ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Për më tepër ligjin krijon procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore, mbështetur në shfrytëzimin dhe qëllimin, si dhe siguron mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorim.

Fushëveprimi i këtij ligji konsiston në rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësorë, liqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre; përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, thatësira, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohet ose shkarkohen ujërat.

Si autoritete kompetente për administrimin e ujërave ligji përcakton MMPH-në, komunat, Këshillin ndër-ministror për ujërat, Institutin e Kosovës për ujërat dhe Autoritetin e rajonit të pellgjeve lumore.

Në nenin 94 të ligjit parashihen dispozitat përkitazi me mbikëqyrjen inspektive. Sipas këtij neni, punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e ligjit dhe dispozitave të

nxjerra në bazë të ligjit i kryejnë Inspektorët e ujërave të Ministrisë dhe inspektorët e autorizuar të ujërave të komunave. Po ashtu, Inspektori i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivel të Kosovës, ndërsa inspektori i autorizuar i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivele komunale. Dispozitat ndëshkimore parashihen me nenin 111 të ligjit. **Ky nen të gjithë personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e ligjit I konsideron si kundërvajtje dhe i gjobitë prej pesëmijë (5000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) EUR**.

2.11. Ligji për Ndërtim

Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2012. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës. Ligji për ndërtimin rregullon ndërtimin e të gjitha objekteve ndërtimore në Kosovë, projektimin, ndërtimin, rindërtimin dhe rrënimin.

Dispozitat lidhur me mbikëqyrjen dhe inspektimin parashihen me nenet 29 dhe 30. Sipas këtyre neneve funksionin e inspektimit të paraparë me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore e kryen Inspekcioni ndërtimor pranë MMPH dhe Inspekcioni ndërtimor i komunave brenda kompetencave të tyre. **Dispozitat lidhur me gjobat dhe ndëshkimet parashihen në nenin 35.** Shtojca Nr. 1 e ligjit parasheh se kompetencat për dhënien e lejes së ndërtimit i takojnë MMPH.

2.12. Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje

Ligji nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2018. Qëllimi i këtij ligji është trajtimi gjithëpërfshirës i ndërtimeve pa leje të ndërtuara deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji; krijimi i procedurave të thjeshtëzuara për ta mundësuar legalizimin dhe për të ndihmuar qytetarët që të realizojnë përfitime nga ndërtimet e tyre; ofrimi i shërbimeve përmes një zyre të vetme shërbyese për legalizim dhe regjistrim të ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave në Kadastër, dhe regjistrimin e pronarit të ndërtimit pa leje dhe pjesëve të ndërtesave në Regjistrin e të Drejtave në Pronë të Paluajtshme dhe identifikimi i ndërtimeve pa leje në mënyrë që komunave t'u mundësohet planifikimi dhe ofrimi më i mirë i shërbimeve për banorët në territorin e tyre.

Ky ligj zbatohet për të gjitha ndërtimet pa leje që janë ndërtuar ose kanë filluar të ndërtohen pa leje deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Autoritetet përgjegjëse për trajtimin e ndërtimeve pa leje janë MMPH, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Instituti për Planifikim Hapësinor dhe ministritë dhe agjencitë tjera përgjegjëse.

2.13. Ligji për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi

Ligji Nr. 04/L-134 për Ndërtesat e banimit në bashkëpronësi ka hyrë në fuqi në korrik të vitit 2013. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive të pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës - bashkëpronësinë në ndërtesë.

Ligji zbatohet për të gjitha ndërtesat për banim, ndërtesat për banim që kanë njësi afariste që janë në pronësi të më shumë së një pronari, si dhe për komplekse të njësive individuale të banimit dhe afariste të cilat kanë në pronësi të përbashkët një territor, në funksion dhe në përdorim, ekskluzivisht të pronarëve të njësive.

Mbikëqyrja administrative dhe inspektive parashihen me nenet 44 dhe 45 të këtij ligji. Përgjegjës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji si dhe mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së administratës komunale është MMPH. Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji, e kryen inspektori komunal i autorizuar për banim në kuadër të organit kompetent për inspektim. Në territoret që janë nën kompetencën e MMPH-së, mbikëqyrjen inspektuese e bënë Inspektorati i MMPH-së. Masat ndëshkimore parashihen në nenin 46 të Ligjit.

2.14. Legjislacioni i Inspektoratit

Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit ka hyrë në fuqi në tetor të vitit 2013. Ligji për inspektoratin rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen inspektuese, koordinimin e mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

Ligjin për Inspektoratin ka në fushëveprim detyrat dhe autorizimet e inspektorëve sipas fushave mbikëqyrëse për mjedis, ujëra, planifikim hapësinor dhe ndërtim në kuadër të organeve të nivelit lokal dhe qendror. Domethënë ky është ligj special që ka të bëjë me autorizimet dhe detyrimet e inspektorëve sipas fushave të mbikëqyrjes.

Kreu III i Ligjit i rregullon detyrat dhe përgjegjësitë e kryeinspektorit dhe inspektorit. Sipas këtij Kreu, kryeinspektori ka në përgjegjësi sigurimin e zbatimit të ligjit, koordinimin e punës së inspektorateve si dhe bashkëpunimit me institucionet tjera, kurse Inspektori ushtron detyrat dhe përgjegjësit e kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera në fuqi.

3. PROCEDURA E ZBATIMIT TË NDËSHKIMEVE ME GJOBA

Ministri i MMPH e bën mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të legjislacionit mjedisor dhe akteve nënligjore. Inspektorati është organi i themeluar me ligj për mbikëqyrjen inspektive të legjislacionit mjedisor. Në lidhje me këtë, Inspektorati mbikëqyrjen e ushtron përmes kontrollit dhe inspektimit në zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjes e natyrës, mbrojtjen e ujërave si dhe inspektimin e ndërtimeve.

Në rastet kur inspektori në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese vlerëson se përveç shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij, janë shkelur edhe dispozitat e ligjeve tjera me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit, është i detyruar që krahas marrjes së masave për të cilat është i autorizuar të njoftoj edhe organet tjera kompetente në mënyrë që bashkërisht të kryejnë mbikëqyrjen inspektuese dhe të ndërmarrin masat e parapara me ligj.

3.1. Procedura e përgjithshme administrative

Ligji Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative ka hyrë në maj të vitit 2017. Ky ligj rregullon parimet, kompetencat dhe procedurën e nxjerrjes së akteve administrative nga ana e administratës shtetërore si dhe subjekteve tjera juridike të cilave me ligj iu është besuar kryerja e autorizimeve publike. Ky ligj ka futur institute, parime dhe veprime procedurale të reja që dallojnë nga ligji i shfuqizuar për procedurën administrative. Këto ndryshime ligjin e ri e bëjnë më lehtë të zbatueshëm por dosido organet administrative i ngarkojnë më me shumë procedura deri në nxjerrjen e aktit administrativ por edhe në procedurën e mjeteve juridike. Ajo çfarë është e rëndësishme për organet zbatuese mjedisore në këtë kontekst, është se të gjitha veprimet procedurale të kryera në kuadër të autorizimeve të tyre duhet të jenë në pajtim me dispozitat dhe parimet e këtij ligji, përveç kur me ligje të veçanta parashihet diçka ndryshe.

Pjesa III e ligjit ka të bëjë me veprimet administrative të cilat më pastaj konkretizohen me kapitujt dhe nënkapitujt vijues.

3.2. Procedura për kundërvajtje

Ligji Nr. 05/L-087 për kundërvajtje ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2017. Ligji rregullon kushtet për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, palët dhe përgjegjësinë për kundërvajtje, procedurën e kundërvajtjes, procedurën e veçantë për të mitur dhe procedurën për ekzekutimin e sanksioneve për kundërvajtje. Ajo çfarë është e rëndësishme përkitazi me këtë ligj është se i njëjti është i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian, përkatësisht Direktivën 2012/13/EU për të drejtën në informim në procedurën penale dhe Direktivën për të drejtën për interpretim dhe përkthim në procedurën penale

Ligji për kundërvajtje është shumë i rëndësishëm për organet zbatuese mjedisore ngase ky parasheh të gjitha veprimet procedurale për sanksionet kundërvajtje – e në këtë rrafsh shumë relevant për shkeljet që parashihen në legjislacionin mjedisor. Nëse shkeljet e legjislacionit mjedisor proceduralisht i nënshtrohen këtij ligji, atëherë zyrtarët mjedisor të cilët marrin pjesë në këtë procedurë duhet të jenë koshient me të gjitha aspektet procedurale të kundërvajtjes.

3.3. Parimet e zbatimit dhe mbikëqyrjes

Në çdo aktivitet kontrollues, inspektues dhe administrativ organet mjedisore duhet të respektojnë parimet e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, parime këto udhëheqëse të procedurës administrative. Në vijim po i paraqesim parimet më të rëndësishme që duhet pasur parasysh zyrtarët mjedisorë.

3.3.1. Parimi i ligjshmërisë

Sipas këtij parimi, organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

3.3.2. Parimi i proporcionalitetit

Sipas këtij parimi, veprimi administrativ, që për arsye të mbrojtjes së interesit publik, kufizon apo cenon të drejtat apo interesat juridike të një personi, duhet të jetë në pajtim me parimin e proporcionalitetit. Kjo domethënë se veprimet administrative duhet të jenë në pajtim me parimin e proporcionalitetit, pra veprimi është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar; është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjesëtim me realizimin e qëllimit të ndjekur.

3.3.3. Parimi i objektivitetit dhe paanësisë

Edhe ky është parim udhëheqës i procedurës administrative. Kjo ngase organet publike duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme dhe veprimet e tyre nuk duhet të ndikohen nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor, politik apo nga presioni politik.

3.4. Raporti zyrtar për kontrollin inspektues

Me rastin e mbikëqyrjes inspektive, inspektori përpilon raport zyrtar për palën e inspektuar (person fizik apo person juridik) me ç'rast përpos konstatimit të gjendjes i jep mundësinë palës së inspektuar që të deklarohet lidhur me përmbajtjen e raportit zyrtar.

Për më tepër, përmes raportit inspektorët i japin një afat të caktuar palës së inspektuar për evitimin e të metave të konstatuara dhe kërkojnë ndërmarrjen e aktiviteteve dhe masave të caktuara.

3.5. Vendimi për ndalimin e përkohshëm të aktiviteteve

Inspektorët me rastin e konstatimit të shkeljeve ligjore, i ndalojnë subjektit përkohësisht aktivitetet që janë në kundërshtim me ligjin.

Vendimi me të cilin ndalohen përkohësisht aktivitetet e caktuara përmban formën e aktit administrativ dhe të gjitha elementet që parashihen me nenin 47 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Pala të cilës i drejtohet vendimi për ndalimin e përkohshëm duhet të udhëzohet të ushtroj ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në kuadër të MMPH-së.

3.6. Raporti zyrtar për riinspektim

Pas ndalimit të aktiviteteve përkohësisht, inspektorët pas lajmërimit të palës së inspektuar për evitimin e të metave të konstatuara dalin për riinspektim. Me këtë rast, përpilohet raporti zyrtar për riinspektim me të cilin konstatohet se janë ndërmarrë të gjitha masat për evitimin e shkeljeve ligjore.

Raporti për riinspektim i jep mundësi palës së inspektuar që të paraqes vërejtjet me shkrim përkitazi me atë raport brenda afatit të caktuar në adresën e inspektoratit.

3.7. Vendimi për lejimin e serishëm të aktivitetit

Pas riinspektimit dhe konstatimit se pala e inspektuar i ka evituar shkeljet ligjore, lëshohet vendimi për lejimin e serishëm të aktivitetit të palës së inspektuar.

Vendimi në dispozitiv duhet të precizojë subjektin të cilit i lejohet vazhdimi i aktiviteteve me adresë të saktë dhe me numër të regjistrimit.

Vendimi përmban formën e aktit administrativ dhe të gjitha elementet që parashihen me nenin 47 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Palës të cilës i drejtohet vendimi për lejimin e serishëm të aktiviteteve duhet të udhëzohet të ushtrojë ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në kuadër të MMPH.

3.8. Vendimi për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë

MMPH, përmes Inspektoratit, sipas autorizimeve ligjore, dhe pas konstatimit të shkeljeve ligjore, nxjerrë vendim për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë.

Vendimi përmban bazën ligjore të autorizimeve inspektuese si dhe bazën ligjore materiale për shkeljet përkatësisht dispozitat ndëshkuese.

Dispozitivi i vendimit duhet të paraqes qartë dispozitat që i përkasin shkeljeve të caktuara si dhe gjobën për ato shkelje. Pjesë e dispozitivit duhet të jetë edhe obligimi i palës të cilës i drejtohet vendimi me afatin dhe llogarinë ku duhet të bëhet pagesa e gjobës. Po ashtu, palës i kërkohet që të prezantojë dëftesë për pagesën e gjobës në adresën e MMPH-së përkatësisht Inspektoratit mjedisor.

Arsyetimi i vendimit duhet t'i sigurojë palës mundësinë që ta kuptojë vendimin dhe të përmbajë shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave dhe bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret.

Ajo se çfarë është e rëndësishme të theksohet në vendim është se edhe pas pranimit të vendimit, pala nuk do të lirohet nga përgjegjësia për shkeljet ligjore të cilat kanë bërë që të nxirret vendimi i mëhershëm për ndalimin e aktiviteteve.

Vendimi për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë përmban formën e aktit administrativ dhe të gjitha elementet që parashihen me nenin 47 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Pala të cilës i drejtohet vendimi për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë duhet të udhëzohet të ushtroj ankesë pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në kuadër të MMPH.

3.9. Vendimi i Komisionit për refuzimin e ankesës kundër vendimit për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë

Komisioni për rishqyrtim i MMPH-së pas pranimit të ankesës të ushtruar kundër vendimit të Inspektoratit për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë në përbërjen e paraparë ligjore e shqyrton ankesën.

Vendimi i shkallës së dytë duhet të përmbajë të gjitha elementet e parapara në pikën 4.5. më lartë.

Pala të cilës i drejtohet vendimi i Komisionit duhet të udhëzohet të iniciojë konfliktin administrativ brenda 30 ditësh në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

3.10. Propozimi për përmbarimin nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm

Pas refuzimit të ankesës të ushtruar kundër vendimit të Inspektoratit për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë, nga pikëpamja e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative vendimi merr formën e prerë dhe inicimi i konfliktit nuk e pezullon efektin e këtij vendimi.

Rrjedhimisht, MMPH në cilësinë e kreditorit dhe në pajtim me Ligjin për procedurën përmbarimore përgatit propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të përmbarueshëm (titullit ekzekutiv), e që në këtë rast është Vendimi për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Propozimi për përmbarim duhet të përmbajë kushtet e parapara me nenin 38 të Ligjit për procedurën përmbarimore.

Më konkretisht, propozimi duhet të nxirret nga MMPH kundrejt debitorit me të gjitha informacione themelore lidhur me debitorin. Propozimi duhet t'a referojë vendimin i cili ka marrë formën e prerë, vlerën e gjobës si dhe afatin për përmbushjen vullnetare të vendimit. I njëjti vendim (Urdhër) duhet t'i komunikohet palës sipas dispozitave të parapara në Pjesën VI të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, përkatësisht dispozitave që kanë të bëjnë me njoftimin e aktit administrativ.

Me propozimin për përmbarim përgatitet edhe Urdhri për përmbaruesin privat i cili në bazë të procedurës e lejon përmbarimin e urdhrit nëse janë plotësuar kushtet ligjore.

3.11. Kërkesa për zhvillim të procedurës së kundërvajtjes në Gjykatë

Organi i kundërvajtjes pas vërtetimit të kushteve për zhvillimin e procedurës sipas detyrës zyrtare, në mënyrë plotësuese do të administroj informacionet dhe provat për kundërvajtjen.

Nëse organi i kundërvajtjes vërteton se ekzistojnë kushtet ligjore për zbatimin e procedurës së kundërvajtjes, është i detyruar që ta zbatojë dhe të nxjerrë vendim për kundërvajtje.

Nëse procedura nuk është në kompetencë të organit të kundërvajtjes, organi i kundërvajtjes është i detyruar që Divizionit për Kundërvajtje të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore të Prishtinës t'ia paraqes kërkesën për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes.

Me këtë rast, duhet të theksohet se Ligji për kundërvajtje parasheh se organi i kundërvajtjes nuk do të nxjerrë vendim për kundërvajtje, përkatësisht nuk do të paraqes kërkesë për zhvillim të procedurës së kundërvajtjes tek gjykata kompetente, nëse vërteton se janë plotësuar kushtet nga nenin 56, paragrafi 2 i këtij ligji.

Sipas nenit 56 paragraf 2 të Ligjit për kundërvajtje parashihet (citoj):

> *[...].Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni organi për kundërvajtje është kompetent që të veproj sipas të gjitha kundërvajtjeve:*
> *2.1. për të cilat është paraparë sanksioni i gjobës në shumën e caktuar;*
> *2.2. për të cilat është paraparë sanksioni për personin fizik gjoba deri në pesëqind (500) euro;*
> *2.3. për të cilat është paraparë sanksioni për personin juridik gjoba deri në njëmijë (1.000) euro, dhe;*
> *2.4. për të cilat është paraparë shqiptimi i gjobës në vend.*

Rrjedhimisht rezulton se organi kundërvajtës e ka në kompetencë ekskluzive zhvillimin e procedurës kundërvajtëse për të gjitha kundërvajtjet e parapara me nenin 56 paragraf 2 të Ligjit për kundërvajtje.

4. LISTA KONTROLLUESE

Në vijim do të paraqitet lista kontrolluese e veprimeve të zyrtarëve mjedisorë që i paraprinë zbatimit të ndëshkimeve me gjoba.

4.1. Përcaktimi i shkeljes ligjore dhe dispozitave përkatëse inspektive dhe ndëshkuese

Zyrtarët mjedisor me rastin e shkeljeve ligjore duhet të përcaktojnë:

- ✓ Bazën ligjore të autorizimeve të tij/saj, dhe
- ✓ Dispozitat përkatëse ndëshkuese (Shih Shtojca 1 dhe Shtojca 10).

4.2. Përpilimi i Raportit Zyrtar (kontrollimi inspektues)

Raporti zyrtar përmban informata që e bëjnë të besueshëm inspektimin e bërë nga zyrtarët mjedisorë (Shih Shtojca 2).

Këto informata përfshijnë por nuk kufizohen në:

- ✓ Kohën e inspektimit;
- ✓ Palët e inspektuara;
- ✓ Inspektorët mjedisorë;
- ✓ Bazën ligjore të inspektimit dhe kontrollimit;
- ✓ Gjendjen e konstatuar faktike;
- ✓ Afatin për masat që duhet të ndërmarrin palët e inspektuara;
- ✓ Deklarimin e palëve të inspektuara;
- ✓ Nënshkrimin dhe vulën zyrtare.

4.3. Nxjerrja e Vendimit për ndalimin përkohësisht të aktiviteteve

Vendimi përmban informacionet e parapara me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, dhe më konkretisht (Shih Shtojca 3):

- ✓ Bazën ligjore të vendimit;
- ✓ Informacionet themelore për palën, si
  - Emrin dhe mbiemrin (apo emrin e ndërmarrjes);
  - Vendbanimin (selinë);
  - Numrin personal (NRB).
- ✓ Dispozitivin;
- ✓ Arsyetimin;
- ✓ Hyrjen në fuqi të vendimit;
- ✓ Udhëzimin për mjetin juridik.

4.4. Përpilimi i Raportit Zyrtar për riinspektim

Raporti zyrtar për riinspektim duhet të përmbajë informata të cilat e bëjnë të besueshëm inspektimin e bërë nga zyrtarët mjedisorë (Shih Shtojca 4).

Këto informata përfshijnë por nuk kufizohen në:

- ✓ Kohën e riinspektimit;
- ✓ Palët e inspektuara;
- ✓ Inspektorët mjedisorë;
- ✓ Bazën ligjore të riinspektimit;
- ✓ Gjendjen e konstatuar faktike;
- ✓ Konstatimin e masave të ndërmarra nga palët e inspektuara;
- ✓ Deklarimin e palëve të inspektuara;
- ✓ Nënshkrimin dhe vulën zyrtare.

4.5. Nxjerrja e Vendimit për lejimin e serishëm të aktiviteteve

Vendimi përmban informacionet e parapara me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, dhe më konkretisht (Shih Shtojca 5):

- ✓ Bazën ligjore të vendimit;
- ✓ Informacionet themelore për palën;
  - o Emrin dhe mbiemrin (emrin e ndërmarrjes);
  - o vendbanimin (selinë);
  - o numrin personal (NRB);
- ✓ Dispozitivin;
- ✓ Arsyetimin e vendimit;
- ✓ Hyrjen në fuqi të vendimit;
- ✓ Udhëzimin për mjetin juridik.

4.6. Nxjerrja e Vendimit për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë

Vendimi për Shqiptimin e Ndëshkimit me Gjobë përmban informacionet e parapara me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, dhe më konkretisht (Shih Shtojca 6):

- ✓ Bazën ligjore të vendimit;
- ✓ Informacionet themelore për palën, si:
  - o emrin dhe mbiemrin (emrin e ndërmarrjes);
  - o vendbanimin (selinë);
  - o numrin personal (NRB);
- ✓ Dispozitivin;
- ✓ Arsyetimin ;
- ✓ Hyrjen në fuqi të vendimit;

- ✓ Paralajmërimin për palën për afatin e pagesës së gjobës;
- ✓ Udhëzimin për mjetin juridik.

4.7. Vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e ankesës

Vendimi përmban informacionet e parapara me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, dhe më konkretisht (Shih Shtojca 6):

- ✓ Bazën ligjore të vendimit;
- ✓ Informacionet themelore për palën, si:
  - o emrin dhe mbiemrin (emrin e ndërmarrjes);
  - o vendbanimin (selinë);
  - o numrin personal (NRB).
- ✓ Dispozitivin;
- ✓ Arsyetimin;
- ✓ Hyrjen në fuqi të vendimit;
- ✓ Udhëzimin për mjetin juridik.

4.8. Propozimi për përmbarim

Propozimi për përmbarim duhet të përmbajë kushtet e parapara me nenin 38 të Ligjit për procedurën përmbarimore, dhe më konkretisht (Shih Shtojca 7):

- ✓ Bazën ligjore të propozimit;
- ✓ Informacionet themelore për kreditorin dhe debitorin, si:
  - o emrin dhe mbiemrin (emrin e ndërmarrjes);
  - o vendbanimin (selinë);
  - o numrin personal (NRB).
- ✓ Shumën e pagesës që duhet të paguajë debitori;
- ✓ Mbulimin e shpenzimeve të procedurës përmbarimore;
- ✓ Titulli përmbarues/dokumenti i besueshëm;
- ✓ Urdhri për caktimin e përmbarimit;
- ✓ Palëve të cilave iu dërgohet Propozimi;
- ✓ Vendi dhe data e nënshkrimit të Propozimit;

4.9. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes

Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes duhet të përmbajë kushtet e parapara me Ligjin për procedurën kundërvajtëse, dhe më konkretisht (Shih Shtojca 9):

- ✓ Gjykatën të cilës i drejtohet kërkesa;
- ✓ Bazën ligjore të kërkesës;
- ✓ Të dhënat themelore për kundërvajtësin, si:

- emrin dhe mbiemrin (emrin e ndërmarrjes);
- vendbanimin (selinë);
- numrin personal (NRB).

✓ Përshkrimin e fakteve;
✓ Kualifikimin e kundërvajtjes;
✓ Shumën e dëmit të shkaktuar;
✓ Provat e propozuara si:
- incizimet;
- fotografitë;
- deklaratat;
- procesverbalet (raportet), etj.


✓ Vendi dhe datën e nënshkrimit të Kërkesës.

5. PROCEDURAT E SHQIPTIMIT TE NDESHKIMEVE ME GJOBE

5.1. Skema e procedurës se shqiptimit të ndëshkimeve me gjobë

Dispozitat e mbikëqyrjes inspektive dhe të ndëshkimeve të paraqitura më lartë duhet aplikohen në bazë të procedurës të paraqitur në skemën e mëposhtme duke shfrytëzuar mostrat e paraqitura më poshtë.

Me qëllim të ilustrimit të procedurës, më poshtë po marrim një shembull të sekuencës së hartimit të dokumenteve të nevojshme për shqiptimin e ndëshkimeve me gjoba nga ana e inspektorëve.



(Skema 1: Skema e procedurës se shqiptimit te ndëshkimeve me gjobe)

5.2. Procedura e Vendimit për ndëshkimin me gjobë deri në përmbarim

Hapi 1
Raporti zyrtar për kontrollim inspektues.



Hapi 2
Vendimi për ndalimin e përkohshëm të aktivitetit.



Hapi 3
Raporti zyrtar për riinspektim.



Hapi 4
Vendimi për lejimin e aktivitetit.



Hapi 5
Vendimi për shqiptimin e gjobës.



Hapi 6
Vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e ankesës.



Hapi7
Urdhri për ekzekutimin vullnetar të vendimit për gjobë.



Hapi 8
Propozimi për përmbarimin nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

5.3. Procedura e ndëshkimit me gjobë - sipas konfliktit administrativ

Hapi 1
Raporti zyrtar për kontrollim inspektues.



Hapi 2
Vendimi për shqiptimin e gjobës.



Hapi 3
Vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e ankesës .



Hapi 4
Inicimi i Padisë pranë Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.



Hapi 5
Nëse miratohet Padia, Inspektorati përmes Zyrës Ligjore ankohet në Gjykatën e Apelit.




Hapi 6
Gjykata e Apelit mund ta miratojë ankesën dhe çështjen ta ktheje në rigjykim apo ta vendosë në meritë. Nëse Gjykata e Apelit e vendosë lëndën ajo merr formën e prerë.



Hapi7
Propozimi për përmbarimin nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

5.4. Procedura para Gjykatës së Kundërvajtjes

Me qëllim të ilustrimit të procedurës së kundërvajtjes, më poshtë paraqitet skema e procedurës si dhe sekuencat e veprimeve që duhet të ndërmarrin inspektorët dhe zyrtarët ligjorë të MMPH-së.



(Skema 2: Procedura para Gjykatës së Kundërvajtjes)

Hapi 1
Organi kundërvajtës nxjerrë Aktvendim për Kundërvajtje



Hapi 2
Nëse procedura nuk është në kompetencë të organit, paraqitet kërkesa për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse pranë Divizioni për Kundërvajtje – GJTH



Hapi 3
Organi i kundërvajtjes përshtatshmërish i zbaton dispozitat e Ligjit për Procedurën e përgjithshme administrative



Hapi 4
Procedura fillon në bazë të Kërkesës për fillimin e procedurës së kundërvajtjes të cilën e paraqesin inspektorët mjedisorë dhe zyra ligjore e MMPH



Hapi 5
Gjykata zhvillon procedurën e kundërvajtjes



Hapi 6
Paraqitësi i Kërkesës (inspektori) thirret në cilësinë e dëshmitarit



Hapi7
Gjykata vendosë me Aktgjykim, Aktvendim dhe Urdhëresë



Hapi 8
Kundër Aktgjykimit për Kundërvajtje, MMPH/Zyra Ligjore paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit – Divizioni për Kundërvajtje



Hapi 9
Heqja dorë dhe abstenimi nga e drejta për paraqitjen e ankesës nuk mund të revokohet.

SHTOJCË 2: Raport zyrtar (kontrollimi inspektues)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

Nr.__/_____

RAPORT ZYRTAR

I hartuar me dt._____, përkitazi me kontrollimin inspektues _____ i regjistruar në _____, me nr: _____.

PREZENT:

PËR PALËN E INSPEKTUAR:	INSPEKTORI/ËT MJEDISOR
1._____	1._____
2._____	2._____
3._____	3._____

filluar:_____

Inspektori/ët mjedisor duke vepruar sipas autorizimeve të nenit _____ të Ligjit _____, pas kontrollimiti të dokumentacionit dhe administrimit të provave tjera përkatëse konstatuan këtë gjendje faktike:

_____
_____
_____
_____
_____
_____

_____
_____
_____
_____
_____
_____

Bazuar në gjendjen e konstatuar, inspektori/ët, për evitimin e të metave të konstatuara, urdhëron/jnë palën e inspektuar që të ndërmarrë këto veprime/masa:

_____
_____
_____
_____

Afati:_____

Lidhur me gjendjen e konstatuar pala e inspektuar deklraron:_____
_____
_____
_____
_____

Pala e inspektuar ka mundësi, brenda afatit të caktuar nga inspektori/ët t'i paraqes vërejtjet në gjendjen e konstatuar, të cilat konsiderohen pjesë përbërëse e raportit zyrtar. Raporti zyrtar është hartuar në pajtim me dispozitat e nenit ___ të Ligjit _____. Një kopje i lihet palës së inspektuar, kurse kopjet tjera mbahen nga inspektori/ët për procedurën e mëtutjeshme.
Kontrollimi inspektues kryhet më dt. _____, në orën_____.

PËR PALËN E INSPEKTUAR:	INSPEKTORI/ËT MJEDISOR
1._____	1._____
2._____	2._____
3._____	3._____

[vula zyrtare]

SHTOJCË 3: Vendim për ndalimin e përkohshëm të aktivitetit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

Nr.__/_____

Inspektorët mjedisorë z./znj _____ nr._____ dhe z/znj._____ nr. _____, bazuar në dispozitat e nenit _____ të Ligjit _____, dispozitën e nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datën _____ nxjerrin këtë:

V E N D I M

I. NDALOHET PËRKOHËSISHT procesi i punës ndaj subjektit juridik/fizik _____ me adresë në _____.

II. Ndalesa e përkohshme nga paragrafi I i këtij Vendimi zgjatë deri sa subjekti I lartcekur t'i eliminojë të metat e konstatuara në Raportin Zyrtar Nr._____ të datës _____.

III. Obligohet subjekti i lartcekur pasi që të kryhen obligimet nga paragrafi II i këtij Vendimi, menjëherë ta njoftojë Inspektoratin mjedisor me shkrim në rrugën zyrat e inspektoratit në ish Pallatin e Rilindjes, Kati 13, Prishtinë, i cili do të nxjerrë Vendimin përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me rastin e komunikimit te pala.

Prishtinë, _____

[vula zyrtare]

SHTOJCË 4: Raport zyrtar (Riinspektim)



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

Nr.__/_____

RAPORT ZYRTAR
Riinspektim

Përpiluar më: _____ në Prishtinë.
Filloi në ora:_____
Subjekti: _____. NRB:_____.
Adresa:_____
Pronar:_____
Prezent:_____

Inspektori/ët mjedisor duke vepruar sipas autorizimeve të nenit __ të Ligjit _____, pas kontrollimiti të dokumentacionit dhe administrimit të provave tjera përkatëse konstatuan këtë gjendje faktike:

_____
_____
_____
_____

Përpilimi i këtij Raporti Zyrtar mori fund në ora: _____ me datën _____.

Vërejtjet eventuale të paraqitura do të jenë pjesë përbërëse e këtij Raporti Zyrtar.

Raporti është përpiluar në 2 (dy) ekzemplarë, një i mbetet palës së inspektuar, kurse një e mbanë Inspektori mjedisor për procedurë të mëtutjeshme.

Pala prezente Inspektori
_____ [vula zyrtare] _____

SHTOJCË 5: Vendim për lejimin e aktivitetit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

Nr.__/_____

Inspektoët mjedisorë _____ nr._____ dhe _____ nr. _____, bazuar në dispozitat e nenit _____ të Ligjit _____, dispozitën e nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më datën _____ nxjerrin këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET procesi i punës ndaj subjektiti juridik/fizik _____ me adresë në _____.

Ky vendim hyn në fuqi me rastin e komunikimit te pala.

Prishtinë, _____

Arsyetim

Pas ndalimit të përkohshëm të punës në _____ pronë e subjektit të lartcekur dhe vendimit për eliminimin e rrezikut për_____, pala e inspektuar ka lajmëruar Inspektoratin dhe ka kërkuar që të bëjë inspektimin për të konstatuar se ka zbatuar vendimin _____.

[vula zyrtare]

SHTOJCË 6: Vendim për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

Nr.__/_____

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit, në procedurën kundërvajtëse kundër ndërmarrjes "Ali Baba" sh.p.k., me seli në rr. Çamëria nr. 10 në Vushtrri, bazuar në dispozitat e nenit 94 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e mjedisit dhe nenin 56 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtjen, në seancën e mbajtur më _____, nxjerrë këtë:

VENDIM
Për shqiptimin e ndëshkimit me gjobë

I. SHPALLET PËRGJEGJËS ndërmarrja "ALI BABA" sh.p.k. me NRB: 00000000 për arsye se me datën 10.11.2018 ka prodhuar dhe ka lëshuar në treg substanca të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit dhe kësisoj ka kryer kundërvajtje të paraparë me nenin 45 para. 1 dhe 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit në bashkëveprim me nenin 94 para. 1.2 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit.

II. Ndërmarrja "ALI BABA" sh.p.k. dënohet me gjobë prej 1,000.00 (njëmijë) EUR për kundërvajtjen nga pika I e dispozitivit, të cilën duhet ta paguajë brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Në rast të mos-pagesës, shuma e caktuar do të arkëtohet me dhunë në pajtim me dispozitat e ligjit.

III. Ndërmarrja "ALI BABA" sh.p.k. është e obliguar që pagesën e gjobës ta bëjë në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në bankën _____ në numrin e llogarisë: _____ në emër të Inspektoratit mjedisor.

Dëftesa mbi pagimin e gjobës merret në zyrat e inspektoratit në ish Pallatin e Rilindjes, Kati 13, Prishtinë.

Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e këtij vendimi.

ARSYETIM

Me datën 10.11.2018 pranë Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit është denoncuar prodhimi i substancave dhe preparateve kimike nga ana e HALIM HALIMIT.

Me të marrë informacionin, Inspektori mjedisor ka shkuar në vendin e ngjarjes me ç'rast ka konstatuar se punëtorët e ndërmarrjes "Ali Baba" sh.p.k. kanë prodhuar dhe kanë lëshuar në treg substancat të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit.

Me atë rast, Inspektori ka hartuar procesverbalin nga vendi i ngjarjes, ka fotografuar makinerinë e prodhimit të substancave si dhe ka konfiskuar atë. Më pastaj, inspektori ka marrë deklaratën e dëshmitarit HALIM HALIMI të cilën e ka bashkangjitur në procesverbalin e ngjarjes. Një kopje të procesverbalit Inspektori ia ka ofruar edhe punëtorëve të ndërmarrjes "ALI BABA" sh.p.k. që ta nënshkruajnë.

Me veprimet e përshkruara më lartë, ndërmarrja "ALI BABA" sh.p.k. ka shkelur nenin 45 para. 1 dhe 2 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, dhe Inspektorati ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit
Prishtinë, më 11.11.2018

Nr. __/_____

[Zyrtari përgjegjës]

[vula zyrtare]

Këshilla juridike: Kundër këtij Vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 (tetë) ditësh nga pranimit i të njëjtit, pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

SHTOJCË 7: Vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e ankesës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

Nr.__/_____

Bazuar në dispozitat e nenit __ të Ligjit _____, dispozitat e nenit __ të Ligjit _____, dispozitat e nenit __ të Ligjit _____, dispozitat e nenit __ të Ligjit _____, Komisioni i rishqyrtues në përbërje të _____ - kryetar, _____ - anëtar, _____ - anëtar, duke vendosur sipas ankesës të subjektit _____me adresë në _____ të ushtruar kundër Vendimit të shkallës së parë nr._____ , në seancën e mbajtur më _____, nxjerrë këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar Ankesa e palës në procedurë _____ me NRB: _____ me seli në _____ me pronar _____.

VËRTETOHET vendimi I organit të shkallës së parë të Inspektoratit Mjedisor Nr. _____ i datës _____.

ARSYETIM

_____
_____
_____
_____

Kryetari i Komisionit rishqyrtues
[vula zyrtare dhe nënshkrimi]

Këshilla juridike: Kundër këtij Vendimi mund të inicohet konflikti administrativ në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit

SHTOJCË 8: Propozimi për përmbarim/Urdhri përmbarues



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria –Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit / Inspektorat Zaštite Sredine / Environmental Protection Inspectorate

KREDITOR: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit me adresë në ndërtesën e ish-Pallatit të Rilindjes kati 13, 10000 Prishtine.

DEBITOR: ALI BABA" sh.p.k. me seli në rr. Çamëria nr. 10 në Vushtrri, me numër të regjistrimit të biznesit: 000000000, përfaqësuar me autorizim nga _____.

PROPOZIM PËR PËRMBARIM

- Për pagesën e gjobës në shumën prej: 1,000.00 EUR (me shkronja: njëmijë)

- Për mbulimin e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, aq sa ato të krijohen sipas llogarisë të Përmbaruesit Privat, në pajtim me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 06/2014

Në bazë të titullit përmbarues, dokument i besueshëm:

Vendimi Nr. __/____ i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit i datës __/__/____ në shumën prej 1,000.00 EUR;

Vendimi i lartcekur i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit i është komunikuar palës me datën __/__/____.

Meqenëse Debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij, i cili del nga Vendimi si më lartë, Kreditori detyrohet që gjobën e përmendur, të papërmbushur deri më tani nga Debitori, ta kërkojë përmes procedurës së përmbarimit.

Nga të lartcekurat, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në pajtueshmëri të plotë me nenin 21, nenin 29 par.1.4 dhe nenin 38 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore 04/L-139, kërkojmë të nxjerrë:

U R DH Ë R
PËR CAKTIMIN E PËRMBARIMIT

I. LEJOHET PËRMBARIMI i propozuar dhe njëherit URDHËROHET debitori ALI BABA" sh.p.k. me seli në rrugën me seli në rr. Çamëria nr. 10 në Vushtrri, me numër të regjistrimit të biznesit: 000000000, me numër fiskal: 000000000, që në emër të vendimit datës__/__/____ të përcaktuar në shumën prej: 1,000.00 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, aq sa ato do të krijohen në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MD Nr.06/2014; të kryejë pagesën në afat ligjor, nga dita e pranimit të Këtij Urdhri, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

II. Përmbushjen e detyrimeve të Debitorit ndaj Kreditorit:

- Me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të Debitorit dhe transferimin e të hollave në llogarinë e Kreditorit, duke i shtuar shpenzimet lidhur me veprimet përmbarimore konform nenit 152-166 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit 168-172 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

- Me sekuestrimin e letrave me vlerë (neni 168-172 Ligjit për Procedurën Përmbarimore);

- Me sekuestrimin, vlerësimin, me shënimin e përmbarimit në librin publik të paluejtshmërive, dërgimin, të besuarit për ruajtje, me shitjen e sendeve dhe përmbushjen e Kreditorit nga shuma e fituar me shitje (neni 109-271 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore);

- Përmbarimi për pjesën e pasurisë së Debitorit në shoqërinë tregtare (neni 173 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore);

- Me qëllim të dorëzimit të sendeve të luajtshme (neni 275-280 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore).

Kreditori e fiton të drejtën e pengut për sendet e luajtshme të inventarizuara (neni 192 para.1 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore).

I ndalohet Debitorit dhe personave tjerë dhe organeve të cilët marrin pjesë në zbatimin e përmbarimit/ çfarëdo disponimi dhe fshehje e pasurisë së Debitorit.

Veprimi i kundërt i nënshtrohet përgjegjësisë penale dhe civile juridike.

Dërguar:
1.Kreditorit
2.Debitorit
3……..,

(personave dhe organeve të cilët marrin pjesë në zbatimin e përmbarimit)

Në Prishtinë, më __/__/____

Përfaqësuesi i Kreditorit:

_____

SHTOJCË 9: Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes

Për: GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni për Kundërvajtje

K Ë R K E S Ë
për
Fillimin e procedurës së kundërvajtjes

I/e nderuar,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit në pajtim me dispozitat e nenit 86 dhe 87 të Ligjit Nr. 05/L-087 të Ligjit për Kundërvajtje parashtron kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes ndaj të pandehurit me të dhënat në vijim:

Të dhënat themelore
Hysen (Hasan) Hyseni nga Vushtrria me vendbanim në rr. Çamëria nr. 10 në Vushtrri, me numër personal 123456789, i lindur më 01.01.1987, i punësuar në ndërmarrjen "Ali Baba" sh.p.k., me profesion inxhinier.

Përshkrimi i fakteve
Me datën 10.11.2018 pranë Inspektoratit për Mbrojtjen e Mjedisit është denoncuar ndotja e ujit dhe shkarkimi I mbeturinave nga ana e Halim Halimit. Me të marrë informacionin, Inspektori I ujërave ka shkuar në vendin e ngjarjes me ç'rast ka konstatuar se i pandehuri ka ndotur lumin duke hedhur ujëra të ndotura. Me atë rast, Inspektori ka hartuar procesverbalin nga vendi i ngjarjes, ka fotografuar vendin e ngjarjes, si dhe ka konfiskuar makinerinë me të cilat janë hedhur ujërat e ndotura. Më pastaj, inspektori ka marrë deklaratën e dëshmitarit Halim Halimi të cilën e ka bashkangjitur në procesverbalin e ngjarjes. Një kopje të procesverbalit Inspektori ia ka ofruar të pandehurit që t'a nënshkruaj.

Kualifikimi i kundërvajtjes
Me veprimet e përshkruara më lartë, i pandehuri ka shkelur nenin 60 para. 1 të Ligjit për Ujërat.

Shuma e dëmit të shkaktuar
Shuma e kalkuluar e dëmit të shkaktuar nga i pandehuri llogaritet të jetë 5,000.00 (dymijë) EUR.

Gjykatës i propozojmë që të administrojë provat në vijim:

- Incizimin nga vendi i ngjarjes;
- Fotografitë nga vendi i ngjarjes;
- Deklaratën e dëshmitarit;
- Deklaratën (dëshminë) e Inspektorit;
- Procesverbalin e hartuar nga inspektori, dhe
- Fotografitë e mjeteve të konfiskuara.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit

Prishtinë, më _____

Zyrtari përgjegjës

[vula zyrtare dhe nënshkrimi]

SHTOJCË 10: DISPOZITAT MBIKËQYRËSE DHE NDËSHKUESE

Ligji Mbrojtjen e Mjedisit

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 81
Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji si dhe akteve nënligjore të nxjerra prej tij, kushtet dhe metodën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektorati mjedisor i Ministrisë.
2. Mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen inspektori komunal i mjedisit.
3. Ministria mundet me autorizim të veçantë, të autorizoj inspektorin komunal të mjedisit për kryerjen e detyrave tjera.
4. Punët e inspektorit mund t`i kryej edhe zyrtari tjetër për mbrojtjen e mjedisit të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht komuna.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 93
Kundërvajtjet

1. Me gjobë në të holla prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik nëse:
1.1. shfrytëzon resurset natyrore pa pëlqimin mjedisor te Ministrisë (neni 10 paragrafi 2. të këtij ligji);
1.2. gjatë shfrytëzimit të resurseve natyrore, kryerjes së punëve, si dhe pas përfundimit të tyre nuk i zbaton masat e parapara për parandalimin e rrezikimit të mjedisit (neni11 paragrafi 1 të këtij ligji);
1.3. nuk bënë sanimin dhe rekultivimin ose nëse në ndonjë mënyrë tjetër nuk bënë rehabilitimin e mjedisit të degraduar (neni 11 paragrafi 2 të këtij ligji);
1.4. zhvillon aktivitete në natyrë të cilat degradojnë veçoritë e vlerave natyrore (neni 12 paragrafi 2 të këtij ligji);
1.5. gjatë administrimit me materie të rrezikshme nuk ndërmerr të gjitha masat e duhura mbrojtëse dhe të sigurisë (neni 16 paragrafi 2 të këtij ligji);
1.6. në rast të tejkalimit të normave të lejuara të emisionit, cilësisë të mjedisit dhe aktiviteteve tjera nuk realizon planin sanues (neni 23 paragrafi 3 të këtij ligji);
1.7. nuk e kthen pjesën e dëmtuar të mjedisit në gjendjen që nuk paraqet rrezik (neni 34 paragrafi 1 të këtij ligji);
1.8. nuk i paraqet Ministrisë planin për masat që duhet të ndërmerren (neni 34 paragrafi 3 të këtij ligji);
1.9. importon dhe eksporton substanca të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit (neni 45 paragrafi 2 të këtij ligji);
1.10. nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 47 të këtij ligji;
1.11. nuk ndërmerr masa të sanimit sipas planit për mbrojtje në rast të aksidentit mjedisor (neni 49 paragrafi 1 të këtij ligji);
1.12. nuk bënë monitorimin e gjendjes së mjedisit në përputhje me dispozitat e këtë ligji (neni 50 paragrafi 2 të këtij ligji);
1.13. nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 51 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji;
1.14. nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 63 paragrafi 1 të këtij ligji;
1.15. nuk ndërmerr masat e parapara me planin për mbrojtjen nga aksidenti mjedisor (neni 68 paragrafi 1 të këtij ligji);
1.16. nuk i bartë shpenzimet për vlerësimin e dëmit dhe mënjanimin e tij (neni 69 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji);
1.17. nuk sigurohet nga përgjegjësitë në rast të dëmeve të shkaktuara palës së tretë (neni 70 të këtij ligji);
1.18. nuk paguan kompensimin për ndotjen e mjedisit (neni 75 paragrafi 1 të këtij ligji).

2. Me gjobë në të holla në lartësi prej njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro gjobitet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 94
1. Me gjobë në të holla në lartësi prej njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro për kundërvajtje gjobitet personi juridik nëse:
1.1. nuk e siguron lejen e integruar mjedisore (neni 30 paragrafi 1 të këtij ligji);
1.2. prodhon substanca të cilat e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit (neni 45 paragrafi 1 dhe 2 të këtij ligji);
1.3. importon dhe eksporton substanca, prodhimet dhe pajisjet, të cilat e dëmtojnë mbështjellësin ozonit, respektivisht prodhimet të cilat përmbajnë këto substanca, të cilat janë në listën e Protokollit të Montrealit (neni 45 paragrafi 2 i këtij ligji);
1.4. shfrytëzon shenjen EMAS sistemet e certifikuara të menaxhimit të mjedisit ISO 9000,
ISO14001 pa qenë i regjistruar sipas ligjit (neni 42 të këtij ligji);
1.5. përdor etiketën mjedisore në kundërshtim me dispozitat e nenit 43. te këtij ligji.
1.6. nuk i dorëzon Ministrisë të dhënat sipas dispozitave të nenit 53 paragrafi 6 i këtij ligji.;
1.7. kryen monitorimin e mjedisit pa autorizim nga Ministria (neni 61 paragrafët 1. dhe 3. të këtij ligji.);
1.8. nuk mundëson zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, nuk ofron informata dhe të dhënat tjera të nevojshme (neni 88 paragrafi nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij ligji);
1.9. në afatin e caktuar nga inspektori nuk ndërmerr masat e duhura lidhur me mënjanimin e të metave të konstatuara (neni 82 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.3 të këtij ligji).
2. Me gjobë në të holla në lartësi prej treqind (300) deri njëmijë (1.000) Euro gjobitet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni edhe personi përgjegjës i personit juridik.
3. Me gjobë në të holla në lartësi prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni gjobitet edhe personi fizik.

Neni 95
1. Me gjobë në të holla në lartësi prej pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro për kundërvajtje gjobitet personi përgjegjës i organit shtetëror nëse:
1.1. lëshon leje për përdorimin e resurseve natyrore pa pëlqimin e Ministrisë (neni 10 paragrafi 2);
1.2. nxjerr planin hapësinor dhe urbanistik në kundërshtim me dispozitat e nenit 27 të këtij ligji;
1.3. bën regjistrimin e personit juridik e fizik në sistemin EMAS në kundërshtim me dispozitat e nenit 42 të këtij ligji;
1.4. nuk e informon publikun në rast te rrezikut të drejtpërdrejt ose në rast të tejkalimit normave te lejuara të ndotjes së mjedisit sipas dispozitave të nenit 38 të këtij ligji.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 162
Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e kryen inspektori i mbrojtjes së natyrës, në kuadër të inspektoratit mjedisor.
2. Përmbajtjen, formën dhe mënyrën e dhënies të kartës dhe shenjës zyrtare ministri e përcakton me akt nënligjor.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 164

1. Me gjobë, në vlerë së paku dhjetëmijë (10.000) gjer në dyzetmijë (40.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse: 1.1. kryen ndërhyrjen ose veprimin i cili mund të asgjësoj ose shkaktoj dëm të madh ose të përhershëm në zonën e rëndësishme ekologjike (neni 63 paragrafi 4. dhe neni 64 paragrafi 4. të këtij ligji); 1.2. zhdukë llojin e egër autokton (neni 86 paragrafi 3. të këtij ligji). 2. Me gjobë, në

vlerë së paku njëmijë (1.000) gjer në katërmijë (4.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 165
1. Me gjobë, në vlerë së paku katërmijë (4.000) gjer në tridhjetëmijë (30.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse: 1.1. kryen ndërhyrjen për të cilën nuk është marr shqyrtimi për pranueshmerinë për natyrën ose është në kundërshtim me shqyrtimin e marr (neni 34 paragrafi 1. dhe 3. i këtij ligji);
1.2. vepron në kundërshtim të masave për mbrojtjen, ruajtjen, përparimin dhe shfrytëzimin e zonave të mbrojtura dhe vlerave tjera të mbrojtura të natyrës të pacaktuara me Rregulloren për rendin e brendshëm (neni 76 i këtij ligji);
1.3. futë llojin e egër të huaj në natyrë në territorin e Republikës të Kosovës (neni 91 i këtij ligji),
1.4. bënë ri-futjen e llojeve të egra të zhdukura në natyrë në territorin e Republikës të Kosovës pa lejen e Ministrisë (neni 93 i këtij ligji). 2. Me gjobë, në vlerë së paku katërqind (400) gjer në tremijë (3.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 166
1. Me gjobë, në vlerë së paku njëmijë (1.000) gjer në dhjetëmijë (10.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
1.1. në rezervatin strikt kryen veprime të cilat nuk janë të lejuara (neni 10 i këtij ligji);
1.2. shfrytëzon të mirat e natyrës që nuk lejohen për qëllime ekonomike ose kryen ndonjë veprimtari e cila nuk është e lejuar në parkun kombëtar (neni 11 i këtij ligji);
1.3. kryen ndërhyrje dhe punë jo të lejuara të cilat munden me i prishë veçoritë për shkak të cilave është shpallë zona e veçantë (neni 12 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.4. kryen veprimtarit të i cilat rrezikojnë veçoritë dhe rolin e rëndësishëm në parkun e natyrës, ose kryen veprimtari ekonomike dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës pa sigurimin e kushteve për mbrojtjen e natyrës (neni 13. i këtij ligji);
1.5. në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij kryen punë të cilat rrezikojnë veçoritë dhe vlerat e tij (neni 14 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.6. kryen punë dhe veprimtari të cilat prishin veçoritë për shkak të cilave është shpallë peizazhi i mbrojtur (neni 15 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.7. kryen veprimtari dhe punë të cilat ndryshojnë ose prishin vlerat për shkak të cilave është mbrojt monumenti i arkitekturës së parkut (neni 16 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.8. pa arsye të justifikuar shkatërron mineralet, fosilet, shtresimet e mbrojtura dhe vend gjetjet e tyre (neni 18 paragrafi 4. i këtij ligji); 1.9. nuk i mbron llojet vendore të zbutura në mënyrë të përcaktuar (neni 26 i këtij ligji);
1.10. organizon vozitje me automjete jashtë vendbanimeve, në të gjitha llojet e rrugëve, rrugëve fushore, stazave dhe poligoneve të rregulluara pa marrjen e lejes të Ministrisë (neni 30 i këtij ligji);
1.11. lëshon në treg dhe përdorë mjete për mbrojtjen e bimëve dhe plehra artificiale në mënyrën e cila nuk është e lejuar (neni 32 i këtij ligji);
1.12. nuk kryen kushtet e kompensimit sipas mënyrës së përcaktuar (neni 38 paragrafi 3. dhe 5. i këtij ligji);
1.13. pas ndërhyrjes nuk vendos gjendjen e njëjtë ose përafërsisht të njëjtë e cila ishte para ndërhyrjes.” (neni 42 paragrafi 2. i këtij ligji). 1.14. si bartës i ndërhyrjes ose shfrytëzues i të mirave të natyrës pa vonesë nuk mënjanon pasojat e dëmshme (neni 45 i këtij ligji);
1.15. shfrytëzon dhe ekonomizon pyjet në kundërshtim me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe parimeve të certifikimit të pyjeve (neni 47 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji);
1.16. kryen pyllëzimin atje ku nuk është e arsyeshme dhe në mënyrën e cila kërcënon tipin e vendbanimit jo pyjor, të rrallë dhe të kërcënuar (neni 48 i këtij ligji);
1.17. përdor mjete kimike për mbrojtjen e bimëve në pyje pa marrjen e lejes (neni 49 i këtij ligji);
1.18. nuk siguron mbetjen e një përqindjeje të lisave që kanë arrit pjekurinë, të vjetër dhe të tharë sipas kushteve për mbrojtjen e natyrës (neni 50 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.19. nuk e len një pjesë të pa prerë të sipërfaqes të përcaktuar me bazat ekonomiko-pyjore, përkatësisht me kushtet e mbrojtjes së natyrës (neni 50 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.20. nuk ekonomizon në mënyrën e cila në masën më të madhe ruan pjesët pa drunjte dhe skajet e pyjeve (neni 50 paragrafi 4. i këtij ligji);

1.21. dëmton, shkatërron ose bartë botën e gjallë nëntokësore në objektin speleologjik (neni 53 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.22. ndryshon kushtet e vendbanimit në objektin speleologjik duke hedhur mbeturina ose mbetje biologjike, ndez zjarre ose ndonjë mënyrë tjetër (neni 53 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.23. kryen aktivitete ose veprime në objektin speleologjik pa marrjen paraprake të lejes nga Ministria (neni 53 paragrafi 2. i këtij ligji); 1.24. bënë ndarjen e ujë rrjedhës, tharjes të burimit, i mbulon burimet, moçalet etj. dhe me këtë kërcënon vlerat e natyrës dhe larminë biologjike (neni 56 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.25. menaxhon me e kullosave në mënyrën e cila nuk lejohet (neni 59 i këtij ligji);
1.26. nuk i ruan pjesët skajeve të tokës së punueshme si vendbanime (neni 60 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.27. nuk zbaton masat e përcaktuara për ruajtjen e tipave të vendbanimeve në gjendje të favorshme (neni 61 paragrafi 1. i këtij ligji); 1.28. kryen hulumtime pa marrjen e lejes të organit kompetent dhe/ose nuk i dorëzon rezultatet e hulumtimit organit kompetent (neni 71 paragrafi 1. dhe 3. i këtij ligji);
1.29. shqetëson, kap dhe i lëndon shtazët e egra, zvogëlon numrin e popullacionit të llojit të egër, shkatërron ose dëmton vendbanimin e tyre pa ndonjë arsye të justifikuar (neni 86 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.30. nuk zbaton masat, metodat dhe mjetet teknike të cilat më së paku pengojnë llojet egra ose vendbanimet e popullacioneve të tyre (neni 87 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.31. nuk i ndërmerr masat e përcaktuara të mbrojtjes dhe nuk i mirëmban korridoret ekologjik për shtazët e egra (neni 88 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.32. vendos shtylla dhe komponentë teknike në larg përçues të mesëm në mënyrën e cila nuk lejohet (neni 89 i këtij ligji);
1.33. mbledhë bimë, kërpudha dhe pjesë të tyre, si dhe kap dhe vranë shtazë me qëllim të përpunimit, tregtisë, dhe ndonjë qarkullimi tjetër pa marrjen e lejes të Ministrisë si dhe masave të tjera të përcaktuara (neni 90 i këtij ligji);
1.34. shfrytëzon llojet e egra të mbrojtura me kushtet e përcaktuara (neni 94 i këtij ligji);
1.35. përdor mjetet për kapje dhe vrasje të shtazëve të mbrojtura, mjete të cilat munden me shkaktuar zhdukje lokale ose shqetësimin serioz të popullacionit të llojit (neni 95 i këtij ligji);
1.36. bënë tregti me bimët dhe kërpudhat strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vet (neni 97 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.37. me qëllim i kap, i mbanë dhe i mbytë llojet e shtazëve strikt të mbrojtura, i dëmton ose i shkatërron format e tyre zhvillimore, çerdhet ose strofkat, si dhe zonat në të cilat shtohen dhe pushojnë, i shqetësojnë në kohën e shumimit, rritjes së të vegjëlve, migrimit dhe dimërimit, po ashtu me qëllim shkatërron ose merr vezët nga natyra ose mbanë vezët e zbrazura (neni 97 paragrafi 3. nën-paragrafi 3.1., 3.2., 3.3., 3.4., 3.5. dhe 3.6. i këtij ligji);
1.38. fshehë, mbanë, kultivon, bënë tregti, i tjetërson ose në cilën do formë i merr bimët, kërpudhat dhe shtazët, si dhe i preparon llojet e shtazëve strikt të mbrojtura (neni 97 paragrafi 3. nën-paragrafi 3.7. i këtij ligji);
1.39. vepron në kundërshtim me dispozitat për bimët të cilat mbijnë vet, kërpudhat dhe shtazët të cilat gjenden në rezervatin strikt, parkun kombëtar dhe zonën e veçantë si dhe në shtazët nëntokësore (neni 97 paragrafi 4. i këtij ligji);
1.40. mbanë në internim, kultivon, blenë, dhe shet llojet egra strikt të mbrojtura në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara (neni 99 i këtij ligji);
1.41. eksporton ose importon llojet strikt të mbrojtura pa marrjen e lejes të Ministrisë neni 99 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.42. bënë nxjerrjen, futjen, eksportimin, importimin dhe kalimin transit të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve të cilat janë të mbrojtura në bazë të këtij ligji ose konventave ndërkombëtare, pjesëve ose derivateve të tyre pa leje dhe në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe dispozitat për zbatimin e tij (neni 101 i këtij ligji);
1.43. bënë nxjerrjen, futjen, eksportimin, importimin dhe kalimin transit të bimëve, kërpudhave dhe shtazëve të cilat janë të mbrojtura në bazë të këtij ligji ose konventave ndërkombëtare, pjesëve ose derivateve të tyre pa leje përkatëse ose vërtetim të lëshuar nga Ministria dhe aktit të organit të administratës të eksportit ose ri eksportit ose me dokumente të rrejshme, leje ose vërtetim jo të vlefshëm, ose me leje ose vërtetim e cila është ndryshuar pa pëlqimin e Ministrisë ose të vendit të eksportit ose ri eksportit (neni 101 paragrafi 1. i këtij ligji);

1.44. përdor lejen, vërtetimin ose aktin tjetër të nxjerr në bazë të këtij ligji, me qëllim të kryerjes të qarkullimit ndërkufitar dhe tregtisë me lloje të egra, për çfarëdo ekzemplar të llojit të egër për të cilën nuk është lëshuar leja , vërtetimi ose akti tjetër (neni 101 paragrafi 7. dhe/ose neni 107 paragrafi 5. i këtij ligji);
1.45. në kërkesën për lëshimin e lejes për futjen, nxjerrjen, eksportin, importin, vërtetimin për ri eksport, lejeve ose vërtetimeve për tregti përdoret deklarata të rreme ose me qëllim ofron informata të rrejshme për të marr lejen ose vërtetimin (neni 101 paragrafi 1. dhe 4., dhe neni 107 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.46. kryen kalimin transit të llojeve të egra të mbrojtura në bazë të këtij ligji, pjesëve të tyre ose derivateve pa lejen eksportuese të vlefshme ose vërtetimin mbi ri eksportin të lëshuar nga organit të administratës të eksportit ose ri eksportit (neni 101 paragrafi 8. i këtij ligji);
1.47. kryen tregti me lloje të egra të mbrojtura vendore ose të huaj në bazë të ligjit ose marrëveshjeve ndërkombëtare në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me ligj dhe akteve të përcaktuar në bazë të tij (neni 107 i këtij ligji);
1.48. falsifikon ose ndryshon lejen ose vërtetimin dhe nuk ju përmbahet urdhrave dhe kushteve të cituar në vërtetimin për tregti me llojet e egra vendore ose të huaja të mbrojtura në bazë të ligjit (neni 107 paragrafi 1. dhe 4. i këtij ligji);
1.49. nëse pa vonesë nuk e lajmëron Ministrinë mbi të gjitha ndryshimet dhe kushtet e reja të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në vlefshmërinë e lejes ose vërtetimit me qëllim te qarkullimit ndërkufitar ose tregtisë me lloje të egra të mbrojtura, të nxjerra në pajtim me këtë ligji dhe akteve të nxjerra në bazë të tij (neni 109 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.50. nuk jep ofertën për shitjen e patundshmërisë sipas të drejtës së blerësit të parë sipas mënyrës të përcaktuar me këtë ligj (neni 113 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji);
1.51. shet patundshmërinë e cila gjendet në zonën e mbrojtur të natyrës personit tjetër me çmim i cili është më i ulët nga çmimi i cili është dhënë në ofertë të autorizuarve të drejtës së blerësit të parë (neni 113 paragrafi 4. i këtij ligji);
1.52. shfrytëzon të mirat e natyrës në mënyrë të pa lejuar dhe me pasoja të dëmshme (neni 123 i këtij ligji);
1.53. nxjerr planin për ekonomizim me të mirat e natyrës pa pëlqimin e Ministrisë (neni 124 i këtij ligji);
1.54. kryen ndërhyrje dhe punë në vlerën e mbrojtur të natyrës pa leje ose në kundërshtim me kushtet e përcaktuara për mbrojtjen e natyrës (neni 128 i këtij ligji)
1.55. lëshon në treg mineralet, shtresimet dhe fosilet pa leje (neni 137 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.56. eksporton mineralet, shtresimet ose fosilet të cilat janë të mbrojtura si vlera të natyrës (neni 139 paragrafi 2. i këtij ligji).
2. Me gjobë, në vlerë së paku treqind (300) gjer në dymijë (2.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 167

1. Me gjobë, në vlerë së paku pesëqind (500) gjer në njëmijë (1.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
1.1. nuk zbaton masat e mbrojtjes së natyrës të përcaktuara me ligj deri sa vlera e natyrës është nën mbrojtjen paraprake (neni 24 i këtij ligji);
1.2. nuk lejon vizitën dhe shikimin e natyrës (neni 29 i këtij ligji);
1.3. nuk lajmëron zbulimin e objektit speleologjik ose pjesëve të tij në afatin e përcaktuar (neni 52 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.4. kryen hulumtime pa pëlqimin e Ministrisë (neni 67 i këtij ligji);
1.5. nuk vepron në pajtim me planin e menaxhimit e zonës së mbrojtur (neni 81 paragrafi 4. dhe neni 82 i këtij ligji)
1.6. pa arsye të justifikuar kap, lëndon ose vret shtazët e egra (neni 86 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.7. pa arsye të justifikuar mënjanon llojet e egra - bimët dhe kërpudhat - nga vendbanimi i tyre, zvogëlon popullacionin e tyre ose i shkatërron (neni 86 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.8. mbledhë, grumbullon, shkatërron, pret ose nxjerr bimët ose kërpudhat strikt të mbrojtura të cilat mbijnë vetë (neni 97 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.9. mbanë bimët dhe kërpudhat strikt të mbrojtura (neni 97 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.10. kryen hulumtime në llojin strikt të mbrojtur pa lejen e Ministrisë (neni 100 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.11. mbanë në internim në kushte të papërshtatshme dhe pa kujdes të duhur, përkatësisht në kundërshtim me kushtet e përcaktuara për shtazët e egra (neni 104 paragrafi 1. i këtij ligji);

1.12. i ekspozon ne kopshte zoologjike, akuariume, terrariume, ose në hapësirat e ngjashme shtazët e egra vendore apo te huaja të mbrojtura në bazë të ligjit pa lejen e Ministrisë (neni 105 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.13. kultivon llojet vendore të egra ose të huaja pa lejen e Ministrisë (neni 106 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji);
1.14. llojet e egra të kultivuara nuk i shënjon në mënyrë të përcaktuar (neni 106 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.15. nuk bënë sigurimin që shtaza e kultivuar mos të iki në natyrë dhe të shkaktoj dëme (neni 106 paragrafi 4. i këtij ligji);
1.16. kryen hulumtim në vend gjetje që mund të shkaktoj asgjësimin ose dëmtimin e vend gjetjes të mineralit, shtresimit ose fosilit (neni 112 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.17. kryen hulumtime në vend gjetjen e mineraleve, shtresimeve ose fosileve pa lejen e Ministrisë (neni 112 paragrafi 5. i këtij ligji); 1.18. organizon vizita dhe shikime të vlerave të mbrojtura të natyrës në kundërshtim me ndalesat ose kufizimet (neni 129 i këtij ligji); 1.19. nuk lejon qasje në vlerën e mbrojtur të natyrës sipas kushteve të përcaktuara (neni 130 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.20. përkujdeset përkatësisht mbron vlerën e mbrojtur të natyrës në zonën e mbrojtur pa kontratë ose në kundërshtim me kushtet nga kontrata (neni 132 dhe 133 i këtij ligji); 84
1.21. gjatë marrjes të mineraleve, shtresimeve dhe fosileve përdor makineri ose mjete tjera të palejuara (neni 138 paragrafi 1. i këtij ligji); 1.22. nuk mundëson pjesëmarrjen e publikut në hartimin e dispozitave, përkatësisht akteve për shpalljen e vlerave të mbrojtura të natyrës, dokumente e rregullimit hapësinor, planeve të menaxhimit dhe shfrytëzimit të zonave të mbrojtura dhe të mirave të natyrës (neni 151 i këtij ligji).
2. Me gjobë, në vlerë së paku njëqind (100) gjer në pesëqind (500) do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 168

1. Me gjobë, në vlerë së paku pesëqind (500) gjer në njëmijë (1.000) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
1.1. hulumton dhe viziton rezervatin strikt pa lejen e Ministrisë (neni 10 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.2. mbledh bimë, kërpudha dhe pjesë të tyre, si dhe kap ose vret shtazë me qëllim të përpunimit, tregtisë dhe qarkullimit tjetër pa lejen e pronarit dhe përdoruesit të ligjshëm (neni 90 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.3. nxjerr jashtë Republikës së Kosovës për qëllime shkencore llojet e egra dhe pjesët e tyre të cilat nuk janë vlera te mbrojtura të natyrës në kuptim të këtij ligji pa lejen e Ministrisë (neni 71 paragrafi 4. i këtij ligji);
1.4. nuk e lajmëron Ministrinë dhe shërbimin e veterinës për llojet strikt të mbrojtura të ngordhura, të sëmura ose të lënduara (neni 99 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.5. nuk i paraqet Ministrisë dhe Institutit shënimet për rezultatet e hulumtimit në afatin e përcaktuar (neni 100 paragrafi 2. i këtij ligji); 1.6. nuk paraqet importimin ose eksportimin e shtazëve, kërpudhave dhe bimëve në shërbimin kompetent të doganës (neni 102 i këtij ligji);
1.7. nuk informon në afatin e përcaktuar Ministrinë për fitimin e pronësisë në shtazët e mbrojtura (neni 104 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.8. nuk i lëshon vërtetim dhe faturë pronarit të ri për origjinën e shtazës dhe faturën (neni 107 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.9. nuk përkujdeset dhe nuk i mbron mineralet, shtresimet dhe fosilet sipas formës së përcaktuar (neni 110 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji);
1.10. nuk e lajmëron Ministrinë në afatin e përcaktuar zbulimin e mineraleve, fosileve dhe shtresimeve ose nuk ndërmerr masat e domosdoshme për mbrojtjen nga shkatërrimi, dëmtimi ose vjedhja (neni 112 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.11. nuk mundëson hulumtimin e vend gjetjes së mineraleve, fosileve dhe shtresimeve në pajtim me vendimin e lëshuar nga Ministria (neni 112 paragrafi 4. i këtij ligji);
1.12. merr nga natyra minerale, fosile ose shtresime për dedikime të cilat nuk janë përcaktuar me këtë ligj (neni 137 paragrafi 2. i këtij ligji),
1.13. merr nga natyra minerale, fosile ose shtresime me qëllim të shitjes pa lejen e Ministrisë (neni 137 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.14. nuk disponon me prova për prejardhjen e mineraleve, fosileve ose shtresimeve, përkatësisht për lejen për t`i marr nga natyra (neni 137 paragrafi 4. i këtij ligji);
1.15. nuk mbanë evidencë për lëshimin në treg të mineraleve, fosileve ose shtresimeve sipas mënyrës së përcaktuar (neni 137 paragrafi 5. i këtij ligji);

1.16. eksporton minerale, fosile ose shtresime pa lejen e Ministrisë (neni 139 paragrafi 1. i këtij ligji);
1.17. e shfrytëzon shenjen për mbrojtjen e natyrës në kundërshtim me formën e përcaktuar (neni 153 paragrafi 2. i këtij ligji).
2. Me gjobë, në vlerë së paku dyqind (200) gjer në pesëqind (500) Euro do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 169

1. Me gjobë, në vlerë prej njëqind (100) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi fizik nëse në parkun kombëtar, parkun e natyrës dhe monumentin e arkitekturës së parkut : 1.1. kryen aktivitet nënujor pa lejen e Ministrisë, përkatësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës (neni 75 paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. i këtij ligji);
1.2. të ankoroj dhe/ose lidh lundrën jashtë vendit të përcaktuar me plan hapësinor (neni 75 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij ligji);
1.3. kryen peshkim rekreativ pa leje ose në kundërshtim me kushtet e dhëna me leje (neni 75 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3 i këtij ligji);
1.4. dëmton dhe/ose shkatërron shenjen dhe/ose tabelën informuese (neni 75 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. i këtij ligji);
1.5. ndezë zjarr jashtë vendbanimit dhe/ose vendeve që për ketë qellim janë të shënjuara dhe të caktuara (neni 75 paragrafi 1. nën paragrafi 1.5 i këtij ligji);
1.6. xhiron ose fotografon për qëllime komerciale pa lejen e Ministrisë, përkatësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës (neni 75 paragrafi 1. nënparagrafi 1.6. i këtij ligji);
1.7. fluturon me mjete fluturuese pa lejen e Ministrisë përkatësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës (neni 75 paragrafi 1. nënparagrafi 1.7. i këtij ligji);
1.8. vendos pllakën informative, panove reklamuese ose tjera pa lejen e Ministrisë, gjegjësisht organit të administratës ose organit kompetent të komunës (neni 75 paragrafi 1. nënparagrafi 1.8. i këtij ligji).

Neni 170

1. Me gjobë, në vlerë prej tridhjetë (30) Euro do të dënohet për kundërvajtje personi fizik nëse:
1.1. vizita dhe/ose shikimi pa biletë kur ajo është e detyruar; (neni 75 paragrafi 1. nën paragrafi 1.9. i këtij ligji).
1.2. hedhë mbeturina në vendin i cili nuk është paraparë dhe shënjuar për to (neni 75 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.10 i këtij ligji);
1.3. lahet jashtë vendeve të cilat i ka përcaktuar drejtoria (neni 75 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.11 i këtij ligji).

Ligji për Mbeturina

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 62
Mbikëqyrja inspektive

1. Mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij, kushtet dhe mënyrën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut nga mbeturinat, të përcaktuara me këtë ligj e bënë Inspektorati Mjedisor I Ministrisë, dhe inspektorati komunal në kuadër të përgjegjësive sipas këtij ligji.
2. Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t`I kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon Ministria, gjegjësisht komuna në kuadër të përgjegjësive të veta.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 70

Veprat penale

Kur shkeljet e dispozitave të këtij ligji përbëjnë vepër penale sipas Kodit penal, Inspektorati i mjedisit përmes Ministrisë, si dhe inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal.

Neni 71
Kundërvajtjet

1. Me gjobë në të holla prej pesëmijë (5.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi nëse:
1.1. menaxhon me mbeturina pa u licencuar dhe nuk zbaton vendimet për masat shtesë - neni 22 paragrafi 2. dhe 6. i këtij ligji;
1.2. objektet dhe impiantet për menaxhimin e mbeturinave nuk i pajisë me leje përkatëse -neni 23 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.3. ndërton objektet dhe impiantet për menaxhimin e mbeturinave, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nuk i përmbush standardet minimale teknike për veprimtaritë që licencohen -neni 23 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.4. nuk i përfill kushtet e përcaktuara në licencë dhe nuk përfill kushtet dhe kriteret për zgjedhjen e lokacionit të deponive -neni 33 paragrafi 4. dhe 5. i këtij ligji;
1.5. gjatë grumbullimit, ndarjes në lloje, magazinimit, transportimit, trajtimit dhe deponimit, mbeturinat e rrezikshme nuk i ambalazhon dhe paketon sipas rregullave të përcaktuara në aktin nënligjor, nga neni 35 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.6. deponon mbeturinat e rrezikshme pa e bërë trajtimin paraprak ose bënë hollimin e tyre me qëllim të shkarkimit të tyre në mjedis - neni 35 paragrafi 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.7. nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor nga neni 35 paragrafi 5. i këtij ligji;
1.8. nuk ruan dokumentacionin përcjellës për bartjen e mbeturinave të rrezikshme sipas afatit të përcaktuar në nenin 36 paragrafi 4. i këtij ligji;
1.9. bartjen e mbeturinave të rrezikshme nuk e përcjell me dokument të veçantë dhe nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor -neni 37 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.10. nuk zbaton masat shtesë për menaxhimin e mbeturinave -neni 38 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.11. menaxhon me mbeturinat nga ndërtimi dhe demolomi i objekteve ndërtimore pa u licencuar - neni 40 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.12. nuk cakton lokacionin për deponimin dhe nuk nxjerr rregulla për mënyrën e menaxhimit të mbeturinave nga ndërtimet dhe prishjet e objekteve ndërtimore dhe nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor të këtij ligji - neni 40 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji;
1.13. menaxhon me bateritë dhe akumulatorët mbeturinë pa u pajisur me licencë - neni 41 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.14. nuk vendos udhëzimet për klasifikimin në lloje, përmbajtjen e metaleve të rënda, mundësinë e riciklimit ose magazinimit, nuk mban dhe ruan evidencën për sasinë e prodhuar apo importuar si dhe nuk dorëzon bateritë dhe akumulatorët mbeturinë, në vend të caktuar dhe te personat e licencuar – neni 41 paragrafi 2. 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.15. menaxhon me gomat jashtë përdorimit dhe mbeturinat e gomës pa u pajisur me licencë - neni 42 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.16. nuk mban evidencën për sasinë e prodhuar dhe të importuar, për llojin dhe sasinë e mbledhur, trajtuar dhe deponuar, nuk raporton në Ministri si dhe nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor - neni 42 paragrafi 2. 3. 4. dhe 5. i këtij ligji;
1.17. menaxhon me mbeturina elektrike dhe elektronike pa u pajisur me licencë -neni 43 paragrafi 1. I këtij ligji;
1.18. përzien mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike me mbeturinat e llojeve tjera, i deponon ato pa i trajtuar më parë, mbeturinat e lëngëta nga pajisjet elektrike dhe elektronike nuk i grumbullon të ndara dhe nuk i trajton në mënyrë të duhur, dhe nuk mban 1.19. menaxhon me mbeturinat nga gypat fluoreshent pa u pajisur me licencë - neni 44 paragrafi 1. I këtij ligji;
1.20. mbeturinat nga gypat fluoreshent që përmbajnë merkur nuk i mbledhë të ndara, deponon këto mbeturina pa e bërë trajtimin paraprak të tyre, nuk i dorëzon ato te personi i licencuar dhe nuk mbanë evidencën për sasinë e grumbulluar të tyre - neni 44 paragrafi 2., 3.,4. dhe 5. i këtij ligji;

1.21. menaxhon me PCB/PCT dhe mbeturinat me PCB/PCT pa u pajisur me licencë -neni 45 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.22. mbeturinat që përmbajnë PCB/PCT nuk i mbledh, grumbullon dhe klasifikon në lloje, përdor PCB në transformatorë, ripërdor mbeturinat me PCB/PCT dhe riciklon PCB/PCT. - neni 45 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji;
1.23. zotëruesi i pajisjes që përmban PCB/PCT më shumë se 5 dm3 nuk lajmëron pajisjen dhe nuk bënë planin për ndërrimin e sajë, apo trajtimin ose deponimin, nuk mban evidencën për sasinë e grumbulluar të PCB/PCT dhe mbeturinave me PCB/PCT, si dhe nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor të këtij Ligji - neni 45 paragrafi 4. 5. dhe 6. i këtij ligji;
1.24. menaxhon mbeturinat që përmbajnë MOQN pa u pajisur me licencë -neni 46 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.25. nuk mban evidencën për sasinë e grumbulluar dhe të trajtuar të mbeturinave që përmbajnë MOQN - neni 46 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.26. menaxhon me mbeturina që përmbajnë azbest pa u pajisur me licencë - neni 47 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.27. mbeturinat që përmbajnë azbest nuk i mbledh, ndan, paketon, magazinon ose deponon në vendin e caktuar, nuk ndërmerr masa kundër emitimit te fijeve dhe pluhurit te azbestit në mjedis dhe nuk mban evidencën për sasinë e mbeturinave të magazinuara ose deponuara dhe shënimet nuk i dorëzon në Ministri - neni 47 paragrafi 2. 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.28. menaxhon me automjetet mbeturinë pa u licencuar - neni 48 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.29. nuk mbanë evidencën për sasinë e grumbulluar dhe të trajtuar të automjeteve mbeturinë dhe për komponentët e rrezikshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe nuk prezanton librezën e automjetit - neni 48 paragrafi 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.30. menaxhon me mbeturina nga produktet medicinale -neni 49 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.31. mbeturinat që prodhohen gjatë shërbimeve mjekësore nuk i ndan sipas kategorisë në të rrezikshme dhe parrezikshme, nuk nxjerr planin për menaxhimin e mbeturinave dhe nuk cakton personin përgjegjës për zbatimin e planit - neni 49 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji;
1.32. nuk zbaton planin për menaxhimin e mbeturinave nga produktet medicinale dhe nuk zbaton dispozitat a akteve nënligjore - neni 49 paragrafi 4. 5. 6 .dhe 7. i këtij ligji;
1.33. menaxhon me mbeturinat e dioksidit të titanit pa u pajisur me licencë - neni 50 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.34. nuk mban evidencën për sasinë e grumbulluar, magazinuar, trajtuar dhe deponuar të mbeturinave, nuk ndërmerr masat për mbikëqyrjen e operacioneve të deponimit dhe nuk kontrollon dheun, ujin dhe ajrin në lokacionin ku dioksidi i titanit është shfrytëzuar, ruajtur dhe magazinuar – neni 50 paragrafi 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.35. menaxhon me mbeturinat nga ambalazhet dhe paketimet pa u licencuar - neni 51 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.36. përdor materialet për ambalazh të cilat nuk janë prodhuar dhe dizajnuar për t`i përmbush kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut - neni 51 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.37. menaxhon me mbeturinat e biodegradueshme pa u pajisur me licencë - neni 52 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.38. mbledh, demonton dhe trajton mbeturinat e biodegradueshme jashtë qendrës për grumbullimin e tyre - neni 52 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.39. nuk mban evidencën për sasinë e grumbulluar dhe trajtuar të kompostit apo gazit të përfituar nga mbeturinat e biodegradueshme dhe shkelë dispozitat nga akti nënligjor - neni 52 paragrafi 3. dhe 4. I këtij ligji;
1.40. nuk mban shënimet dhe evidencën për prodhimin e lymit nga ujërat e zeza dhe ujërat e ndotura dhe organit kompetent komunal nuk i prezanton shënimet dhe evidencën për to - neni 53 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.41. shfrytëzon mbeturinat nga lymi i kanalizimit pa e bërë stabilizimin e tij dhe pa i bërë përgatitjet e duhura biologjike, kimike, termike dhe përpunimet tjera. - neni 53 paragrafi 4. i këtij ligji;
1.42. menaxhon me mbeturina pa u pajisur me licencë - neni 55 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.43. nuk njofton Ministrinë për veprimet e forcës madhore e cila e ka pamundësuar menaxhimin e mbeturinave sipas kushteve të përcaktuara në licencë - neni 55 paragrafi 7. i këtij ligji;
1.44. bënë qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit të BE – së dhe Konventës së Bazelit dhe sipas rregullave të transportit rrugor (ADR), transportit hekurudhor (RID) dhe transportit ajror - neni 56. paragrafi 1. i këtij ligji;
1.45. importon mbeturinat jo të rrezikshme pa lejen e Ministrisë - neni 56 paragrafi 3. i këtij ligji;

1.46. mbanë mbeturinat që kalojnë transit nëpër territorin e Republikës së Kosovës më gjatë se njëzetë e katër (24) orë - neni 56 paragrafi 6. i këtij ligji;
2. Me gjobë në vlerë prej njëqind (100) deri në
pesëqind (500) Euro do të dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni edhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 72
1. Përpos ndëshkimeve me gjobë për kundërvajtje nga neni 71 paragrafi 1. i këtij ligji, si masë preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, inspektori mund të urdhërojë edhe:
1.1. ndërmarrjen e masave të nevojshme nga personi i cili kryen kundërvajtjen;
1.2. intervenimin e autoritetit kompetent në pronë, në mënyrë që të kryejë punët e nevojshme, me kompensimin e shpenzimeve nga personi i cili kryen kundërvajtjen;
1.3. sekuestrimin e përkohshëm të pajisjeve.

Neni 73
1. Me gjobë në të holla prej dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro dënohet për kundërvajtje personi nëse:
1.1. zotëruesi i mbeturinave respektivisht operatori nuk i klasifikon dhe nuk i përcakton karakteristikat e mbeturinave sipas mënyrës së përcaktuar - neni 7 paragrafi 4. dhe 5. i këtij ligji;
1.2. nuk e nxjerrin planin lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre – neni 10 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.3. nuk e nxjerr planin për pajisjet dhe objektet për menaxhimin e mbeturinave - neni 11 paragrafi 1. I këtij ligji;
1.4. operatori nuk e nxjerr planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave - neni 12 paragrafi 1. I këtij ligji;
1.5. operatori nuk e nxjerr planin operativ për menaxhimin e mbeturinave në deponi - neni 12 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.6. nuk harton raportin vjetor mbi menaxhimin e mbeturinave dhe të cilin nuk e dorëzojnë në Ministri, deri më 31, mars të vitit vijues - neni 15 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij ligji;
1.7. nuk bënë regjistrimin e vendeve te ndotura në territorin e tij - neni 15 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. i këtij ligji;
1.8. nuk ndërmerr masa gjatë mbikëqyrjes dhe kontrollit për menaxhimin e mbeturinave në territorin e vet - neni 15 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.9. nuk jep informacione e kërkuara lidhur me menaxhimin e mbeturinave - neni 15 paragrafi 4. i këtij ligji;
1.10. nuk siguron dhe mundëson largimin e mbeturinave nga hapësirat publike - neni 15 paragrafi 5 dhe 6. i këtij ligji;
1.11. zotëruesi i mbeturinave nuk informon autoritetin kompetent në rast te humbjes, shkapërderdhjes, rrjedhjes, aksidentit ose ndonjë veprim tjetër me mbeturinat të cilat kanë ndikim në ndotjen e mjedisit - neni 16 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.12. nuk i kompenson shpenzimet e menaxhimit të mbeturinave - neni 16 paragrafi 5. i këtij ligji;
1.13. zotëruesi i mbeturinave nuk e harton planin sipas nenit 11 dhe 12 të këtij ligji -neni 16 paragrafi 6. i këtij ligji;
1.14. prodhuesi i produkteve nuk përdor teknikat dhe prodhimtarinë me të cilat sigurohet shfrytëzimi racional i resurseve natyrore, materialeve, energjisë, ku mundësohet ripërdorimi dhe riciklimi i ambalazheve të produktit - neni 17 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.15. prodhuesi dhe importuesi i mallrave, nuk mbledh, grumbullon, trajton, magazinon dhe deponon mbeturinat e krijuara nga produktet e tij si dhe nuk zbaton dispozitat të akteve nënligjore - neni 17 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji;
1.16. nuk nxjerr dhe zbaton planin operativ për menaxhimin e mbeturinave nga neni 11 respektivisht 12 të këtij ligji;
1.17. nuk pajiset me dokumentacion përkatës nga laboratori i autorizuar për përcaktimin e veçorive të rrezikshme të mbeturinave - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij ligji;
1.18. nuk mbledh dhe klasifikon mbeturinat, varësisht nga mënyra e trajtimit te tyre - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij ligji;

1.19. nuk ruan dhe magazinon mbeturinat ne vend te sigurt, duke ndërmarrë masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut - neni 18 paragrafi 1. nënparagrafi 1.4. i këtij ligji;
1.20. nuk i dorëzon mbeturinat personave të licencuar për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. i këtij ligji;
1.21. nuk mban dhe ruan evidencën në regjistrin për mbeturinat të cilat i krijon, dorëzon, trajton dhe deponon - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.6. i këtij ligji;
1.22. nuk autorizon personin të kualifikuar për punët profesionale - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.7. i këtij ligji;
1.23. nuk harton dhe dorëzon raportin vjetor për mbeturinat të cilat i krijon dhe menaxhon te organi kompetent - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.8. i këtij ligji;
1.24. nuk i lejon qasje të lirë organit kompetent të kontrollojë dhe mbikëqyr lokacionin, objektet, impiantet, pajisjet, dhe të inspektoj dokumentacionin për menaxhimin e mbeturinave - neni 18 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.9. i këtij ligji;
1.25. prodhuesi i mbeturinave nuk i bartë shpenzimet për mbledhjen, transportimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave - neni 18 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.26. nuk bënë transportimin e mbeturinave, në bazë të kushteve të përcaktuara në licencë për transportimin e mbeturinave - neni 19 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. i këtij ligji;
1.27. nuk i mundëson organit kompetent qasje të lirë, për kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollimit të automjetit, barrës së ngarkuar dhe dokumentacionit përcjellës - neni 19 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. I këtij ligji;
1.28. nuk mban evidencë në regjistrin për çdo transport të mbeturinave dhe nuk ofron informacione lidhur me transportimin e mbeturinave - neni 19 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij ligji;
1.29. nuk harton planin operativ për menaxhimin e mbeturinave në impiantin për trajtim, sipas nenit 11 respektivisht 12 të këtij ligji dhe nuk siguron zbatimin e tij - neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. I këtij ligji;
1.30. nuk kryen aktivitetet për trajtimin e mbeturinave në përputhje me kushtet e përcaktuara në licencë - neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.2. i këtij ligji;
1.31. nuk menaxhon impiantet, pajisjet dhe aparaturat për trajtimin e mbeturinave, në harmoni me udhëzimet dhe standardet teknike - neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij ligji;
1.32. nuk mban dhe ruan evidencën në regjistrin për mbeturinat - neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi
1.4. i këtij ligji;
1.33. nuk i lejon qasje të lirë organit kompetent për kontrollin dhe mbikëqyrjen e lokacionit, objektit, impiantit, pajisjeve dhe kontrollin e dokumentacionit për menaxhimin e mbeturinave - neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. i këtij ligji;
1.34. nuk autorizon personin fizik apo juridik të kualifikuar për punët profesionale -neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.6. i këtij ligji;
1.35. në rast aksidenti menjëherë nuk njofton organin kompetent - neni 20 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.7. i këtij ligji;
1.36. nuk nxjerr dhe zbaton planin operativ për menaxhimin e mbeturinave në deponi, sipas nenit 12 të
këtij ligji - neni 21 paragrafi 1 .nën-paragrafi 1.1. i këtij ligji;
1.37. nuk deponon mbeturinat, në bazë te kushteve të përcaktuara në licencë - neni 21 paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. i këtij ligji;
1.38. nuk i lejon qasje të lirë organit kompetent që të kontrollojë dhe mbikëqyr deponinë dhe inspekton dokumentacionin e deponisë - neni 21 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. i këtij ligji;
1.39. nuk autorizon personin e kualifikuar për kryerje të punëve profesionale - neni 21 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.4. i këtij ligji;
1.40. nuk mban dhe ruan evidencën në regjistrin për mbeturinat - neni 21 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. i këtij ligji;
1.41. në rast aksidenti, menjëherë nuk njofton organin kompetent - neni 21 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.6. i këtij ligji;
1.42. nuk refuzon pranimin e mbeturinave të cilat nuk mund t'i deponoj, sipas kushteve të përcaktuara në licencë - neni 21 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.43. nuk e nxjerr programin përkatës për menaxhimin e mbeturinave sipas nenit 10 11 dhe 12 të këtij ligji - neni 24 paragrafi 2. dhe 3. i këtij ligji;

1.44. nuk mbledh dhe grumbullon mbeturinat prej prodhuesit dhe zotëruesit dhe nuk i transporton ato deri tek objekti në të cilin bëhet menaxhimi i mbeturinave - neni 25 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.45. mbeturinat e rrezikshme sipas llojeve nuk e klasifikon, mbledhë, grumbullon dhe transporton - neni 25 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.46. mbeturinat nuk i transporton në mënyre të përshtatshme dhe me mjete adekuate -neni 25 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.47. nëse ndodhë ndotja gjatë transportimit të mbeturinave, vendin e ndotur nuk e kthen në gjendje të mëparshme - neni 25 paragrafi 4. i këtij ligji;
1.48. mbeturinën e transportuar e cila nuk është pranuar në vendin e destinuar, transportuesi nuk e kthen në vendin ku është marrë - neni 25 paragrafi 5. i këtij ligji;
1.49. mbeturinat i djeg në kundërshtim me dispozitat e nenit 29, paragrafit 7. dhe kur është e mundur nuk i ripërdor apo përpunon si lëndë e parë sekondare dhe si lëndë për përfitimin e energjisë - neni 30 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.50. mbeturinat që shfrytëzohen si lëndë e parë sekondare nuk i mbledh, transporton, magazinon dhe i klasifikon sipas llojeve - neni 30 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.51. mbeturinat që mund të ripërdoren dhe përpunohen i djeg ose i deponon pa lejen e Ministrisë - neni 30 paragrafi 4. i këtij ligji;
1.52. mbeturinat, kur është e mundur nuk i riciklon dhe nuk i përdor si lëndë e parë sekondare dhe nuk i klasifikon mbledh, transporton dhe magazinohen sipas llojeve -neni 31 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.53. bënë përzierjen e mbeturinave të rrezikshme me lloje të tjera të mbeturinave - neni 31 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.54. mbeturinat që mund të riciklohen i depon ose i djeg pa lejen e Ministrisë - neni 31 paragrafi 5. i këtij ligji;
1.55. mbeturinat nuk magazinon në vende teknikisht të përgatitura për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave dhe nuk i ruan të klasifikuara në lloje dhe sipas veçorive të tyre - neni 32 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.56. mbeturinat e rrezikshme nuk i ruan në magazina për mbeturina të rrezikshme dhe nuk e respekton afatin për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave - neni 32 paragrafi 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.57. deponimin e mbeturinave në deponi e bënë jashtë kushteve të përcaktuara sipas parimit të hierarkisë së mbeturinave dhe nuk i deponon në deponitë e lejuara - neni 33 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.58. nuk zbaton dispozitat e akteve nënligjore nga neni 33 paragrafi 4. dhe 5. i këtij ligji;
1.59. mbeturinat komunale nuk i mbledh, grumbullon, trajton dhe menaxhon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor të këtij ligji si dhe dispozitat tjera ligjore për rregullimin e veprimtarive komunale - neni 34 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.60. mbeturinat komunale të përziera me mbeturina të rrezikshme, nuk i ndan kur ekziston llogaria ekonomike - neni 34 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.61. amvisëritë dhe prodhuesit tjerë të mbeturinave komunale, mbeturinat e tyre nuk i hedhin në vende e caktuara dhe nuk bëjnë ndarjen në lloje - neni 34 paragrafi 4. dhe 6. i këtij ligji;
1.62. komunat nuk organizojnë sistemin për mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme dhe nuk nxjerrin aktin e veçantë për menaxhimin e mbeturinave - neni 34 paragrafi 5. Dhe 7. i këtij ligji;
1.63. bartjen e mbeturinave nuk e përcjell me dokument të veçantë dhe nuk e ruan dokumentacionin përcjellës - neni 36 paragrafi 1. dhe 2. i këtij ligji;
1.64. menaxhon vajrat mbeturinë dhe mbeturinat me vajra pa u licencuar - neni 39 paragrafi 1. i këtij ligji;
1.65. vajrat mbeturinë i derdh, i lëshon në tokë, ujë, në rrjetin e ujërave të zeza, magazinon ose i deponon në vende të papërshtatshme, dhe nëse e bënë dorëzimin e mbeturinave personave të pa licencuar si dhe nuk mban evidencë - neni 39 paragrafi 2. 3. dhe 4. i këtij ligji;
1.66. mbeturinat nga vajrat ushqimore nuk i mbledh, grumbullon dhe dorëzon te personi i licencuar dhe nuk zbaton dispozitat e aktit nënligjor të këtij ligji - neni 39 paragrafi 5. dhe 6. i këtij ligji;
1.67. komunat nuk nxjerrin planin lokal për menaxhimin e mbeturinave dhe nuk dorëzojnë raportin vjetor në Agjencinë për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës - neni 58 paragrafi 3. i këtij ligji;
1.68. zotëruesi dhe prodhuesi i mbeturinave, nuk paraqet raport vjetor në Ministri - neni 58 paragrafi 4. 5. dhe 6. i këtij ligji;
1.69. mjetet financiare të siguruara sipas nenit 59 të këtij ligji nuk i shfrytëzon për qëllimet e caktuara - neni 59 paragrafi 1 i këtij ligji;

1.70. shpenzimet për menaxhimin e mbeturinave dhe sasinë e mbeturinave të krijuara nuk e kalkulon në bazë të parimit "ndotësi paguan" - neni 60 paragrafi 2. 3. dhe 4. i këtij ligji;

Neni 74
1. Me gjobë në vlerë prej pesë (5) deri në njëqind (100) Euro, dënohet për kundërvajtje çdo individ për veprimet me mbeturina që shkaktojnë ndotjen e mjedisit dhe dëmtojnë shëndetin e njeriut.
2. Ministri me akt të veçantë përcakton të gjitha veprimet që do të jenë të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe të cilat do t'i nënshtrohen gjobës nga paragrafit 1. i këtij neni.
3. Për zbatimin e dispozitave të aktit nga paragrafi 2. i këtij neni, përgjegjëse është edhe Policia e Kosovës.

Ligji për kimikate

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 79

Mbikëqyrja dhe inspektimi

1. Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerrura nga ky ligj e bën Ministria.
2. Mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e bënë Inspektorati për mbrojtjen e mjedisit dhe inspektorati fitosanitarë.
3. Mbikëqyrja inspektive të kimikateve në Dogana e Kosovës e bënë Inspektorati fitosanitarë.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 89
Kundërvajtjet dhe masat ndëshkuese

1.Sipas këtij ligji, dënohet për kundërvajtje me gjobë në të holla në vlerë prej:
1.1. njëqind (100) deri në pesëqind (500) Euro, nëse bëhet vendosja në treg apo shitja e kimikateve të rrezikshme në treg nga personat nën moshen tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe nese kimikatet u shiten personave nën moshen tetëmbëdhjetë (18) vjeç sipas paragrafit 3 te nenit 13 të këtij ligji;
1.2. pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi, shitësi dhe përdoruesi I kimikateve nuk zbaton ndalimin, ose kufizimin e kimikateve sipas paragrafit 4 të nenit 13 të këtij ligji;
1.3. njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse personat që i vendosin substancat e rrezikshmedhe përzierjet në treg dhe ato nuk janë të klasifikuara, paketuara dhe etiketuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore që dalin nga ky ligj, sipas paragrafit 1 të nenit 18 dhe paragrafit 1 të nenit 20 të këtij ligji;
1.4. pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i një substance ose përzierje nuk vlerëson informatat e identifikuara, në përputhje me kriteret për klasifikimin dhe përcaktimin e rrezikut që ndërlidhet me substancën apo përzierjen përkatëse, sipas paragrafit 2 të nenit 20 të ketij ligji;
1.5. pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse paketimin e kimikateve nuk e bëjnë në mënyrë të përshtatshme, ashtu që substancat dhe përzierjet brenda paketimit të mos paraqesin ndonjë rrezik për njerëzit dhe mjedisin gjatë ruajtjes, magazinimit apo transportit sipas paragrafi 1 të nenit 23 të këtij ligji;
1.6. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse kimikatet e rrezikshme i vendosin në treg dhe të cilat nuk janë të paketuara në ambalazhe dhe paketime adekuate të specifikuara në dispozitat e këtij Ligji sipas paragrafit 1 të nenit 24 të këtij ligji;
1.7. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse nuk e bëjnë mbylljen e shtrëngueshme dhe nuk vendosin shenjat e prekshme, për kimikatet e rrezikshme për të mbrojtur fëmijët dhe të verbërit sipas paragrafit 2 të nenit 24 të këtij ligji;
1.8. njëmijë (1.000) deri në dymijë e pesëqind (2.500) Euro, nëse në njësinë paketuese të destinuar për shitje me pakicë, e cila përmban kimikate të rrezikshme, i është dhënë forma, pamja që shkakton kureshtje dhe tërheqë fëmijët ose konsumatorin, ose gjason me pamjen dhe formën e ushqimeve për njerëz, kafshë ose medikamente mjekësore ose kozmetike, sipas paragrafit 3 të nenit 24 të këtij ligji;

1.9. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi, furnizuesi nuk ka siguruar që paketimi i substancave ose përzierjeve të cilat i shesin apo shpërndajnë për palen e tretë, të jenë të etiketuara në mënyrë të qartë dhe sipas nenit 27 dhe paragrafit 2 të nenit 25 të këtij ligji;
1.10. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse prodhuesi dhe importuesi, gjatë furnizimit me substanca ose përzierje të rrezikshme për personat e tretë, nuk siguronë që secili paketim të jetë I etiketuar në mënyrë të qartë dhe të përhershme dhe të përmbajnë informatat e specifikuara sipas paragrafit 2 të nenit 27 të këtij ligji;
1.11. pesëqind (500) deri në njëmijepesëqind (1.500) Euro, nëse treguesit, si ''nuk është helmuese'', ''nuk është e dëmshme'', apo treguesit të tjerë të ngjashëm janë vendosur në paketim të substancave apo përzierjeve të rrezikshme sipas paragrafit 4 të nenit 27 të këtij ligji;
1.12. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse për çdo njësi të paketimit të kimikateve të rrezikshme, së bashku me të, nuk ofrohen udhëzimet për përdorim në gjuhët zyrtare sipas paragrafit 6 të nenit 27 të këtij ligji;
1.13. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse etiketimi i substancave nuk përputhet me kërkesat e specifikuara sipas paragrafit 8 të nenit 27 të këtij ligji;
1.14. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse personi bën ç`farëdo reklamimi të substancave kimike që i takojnë një apo më shumë kategorive të specifikuara si të rrezikshme nga neni 6 të këtij ligji dhe nuk ceken qartë kategoritë e rrezikut sipas neneve 7,8,9,10, si dhe paragrafit 1 të nenit 28 të këtij ligji,
1.15. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse për kimikatet të cilat mund të blihen pa etiketë nga ana e publikut të gjërë, gjatë reklamimit të tyre, paraprakisht nuk jepen dhe tregohen në një fletë të veçantë apo me fjalë, të dhëna për vetitë e tyre të rrezikshme në mënyrë të kuptueshme, të qartë dhe të lexueshme, sipas paragrafit 2 të nenit 28 të këtij ligji;
1.16. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse gjatë reklamimit të kimikateve japet përshtypje e gabuar lidhur me rreziqet që ato paraqesin për shëndetin e njëriut dhe mjedisin ose për pranueshmërinë e tyre mjedisore, dhe ato do të inkurajojë përdorimin, trajtimin ose asgjësimin e tyre në mënyrë të papërshtatshme, sipas paragrafit 3 të nenit 28 të këtij ligji;
1.17. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse personi do të përdorë terma të tillë si "I degradueshëm", "ekologjikisht i padëmshëm", "miqësor me mjedisin" dhe " miqësor me-ujë" në reklama por vetitë e përshkruara kështu, nuk janë në të njëjtën kohë të shpjeguara në detaje sipas paragrafit 4 të nenit 28 të këtij ligji;
1.18. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse furnizuesit e substancave të rrezikshme dhe përzierjeve të caktuara, të cilat nuk janë të rrezikshme, por të cilat përmbajnë së paku një substancë të klasifikuar si të rrezikshme, nuk i kanë theksuar vetitë e rrezikshme të saj, kur ajo reklamohet, dhe reklamimi i saj bëhet në atë menyrë që të fshehin vetitë e rrezikshme të asaj substance nga përdoruesit dhe publiku, sipas paragrafit 5 të nenit 28 të këtij ligji;
1.19. pesëmijë (5.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, nëse prodhuesit e substancave dhe nuk sigurojnë që zhvillimi i testimeve, metodave të testimit dhe vlerësimet e rezultateve të testit janë në përputhje me gjendjen aktuale të njohurive shkencore dhe teknike, sipas paragrafit 1 të nenit 29 të këtij ligji;
1.20. pesëmijë (5.000) deri në pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro, nëse personi zhvillon testimet e kimikateve të rrezikshme, që janë të ndaluara në qenie shtazore, sipas paragrafit 2 të nenit 29 të këtij ligji;
1.21. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse personi zhvillon testimet në njerëz që janë të ndaluara sipas paragrafit 3 të nenit 29 të këtij ligji;
1.22. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse testet për përcaktimin e vetive të substancave dhe përzierjeve nuk kryhen në përputhje me metodat e testimit të përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr 440/2008 sipas paragrafit 1 të nenit 30, me perjashtim të paragrafit 2 të nenit 30 të këtij ligji;
1.23. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse testimet e caktuara nuk përputhen me parimet GLP, personi i cili paraqet raportet e testimit dhe nuk deklaron arsyet sipas paragrafi 5 të i nenit 30 të këtij ligji;
1.24. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse laboratori bënë testimet e kimikateve të rrezikshme pa i plotësuar kushtet për zbatimin e GLP sipas paragrafit 2 të nenit 31 të këtij ligji;
1.25. pesëmijë (5.000) deri në njëzetëmijë (20.000) Euro, nëse nuk sigurohet Lista teknike e sigurisë për kimikatet nga prodhuesi, importuesit dhe furnizuesi, sipas paragrafit 1 të nenit 33 të këtij ligji;
1.26. dhjetëmijë (10.000) deri në tridhjetëmijë (30.000) Euro, nëse personi që plotëson Listën teknike të sigurisë për kimikate, nuk jep informacionet e duhura për të informuar përdoruesin e saj për rreziqet që

mund t`i shkaktoj një substancë ose përzierje, dhe nuk japin informacion mbi trajtimin, deponimin dhe asgjësimin e sigurt të substancës apo përzierjes, sipas paragrafit 2 të nenit 33 të këtij ligji;
1.27. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse të dhënat e Listës teknike të sigurisë për kimikatet nuk korrespondojnë me të dhënat në Raportin për sigurinë kimike dhe me ato të skenarit të ekspozimit, sipas paragrafit 5 të nenit 33 të këtij ligji;
1.28. pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro, nëse të dhënat në Listën teknike të sigurisë nga kimikatet nuk paraqiten në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas paragrafit 7 të nenit 33 të këtij ligji;
1.29. dhjetëmijë (10.000) deri në tridhjetëmijë (30.000) Euro, nëse prodhuesi, eksportuesi osfurnizuesi nuk i siguron për marrësit apo përdoruesit, Listën teknike për siguri nga kimikatet, edhe kur përzierja nuk i plotëson kriteret për klasifikim si e rrezikshme, sipas nenit 34 të këtij ligji;
1.30. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesi, eksportuesi ose furnizuesi, nuk bënë rifreskimin e përmbajtjes së Listen teknike të sigurisë për kimikatet, kur ajo është e nevojshme duke përfshirë edhe rastet kur ndalohet ose kufizohet prodhimi, vendosja në treg ose perdorimi i tyre, nuk i njofton të gjithë përdoruesit, si dhe nuk shënon datën e ndryshimit të bërë sipas nenit 36 të këtij ligji;
1.31. njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) Euro, nëse përdoruesi profesional ose tregtari nuk ruan Listën teknike të sigurisë për kimikatet, për aq kohë sa substanca ose përzierjet e caktuara të vazhdojnë të trajtohen dhe perdoren në vendin e punës sipas nenit 37 të këtij ligji;
1.32. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse personat që vendosin në treg kimikate të rrezikshme nuk e hartojnë Raportin e sigurisë nga kimikatet, i cili përmban vlerësimin e sigurisë kimike në përputhje me kërkesat sipas Aneksit I të Rregullores (EC) Nr 1907/2006, për çdo substancë në vete, ose në përzierje, apo për një grup të substancave, sipas paragrafit 1 të nenit 38 të këtij ligji;
1.33. njëmijë (1.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi i substancave dhe përzierjeve nuk njofton Ministrinë dhe nuk dorëzonë kërkesë për regjistrim të substancave dhe përzierjeve në Ministri sipas neni 43 të këtij ligji;
1.34. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi ose përdoruesi i cili është i obliguar t`i dergojë informatat në Ministri, nuk i dërgojnë ato deri më 31 mars të vitit vijues për sasinë e prodhuar, importuar të kimikateve për vitin e kaluar, sipas paragrafit 1 të nenit 44 të këtij ligji;
1.35. tremijë (3.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi nuk i përmbahen masave për redukimin e rrezikut nga paragrafi 2 dhe 3 të nenit 46 të këtij ligji;
1.36. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesit ose importuesit nuk njoftojnë Ministrinë për çdo ndryshim për të dhënat e futura në regjistrin e kimikateve sipas nenit 47 të këtij ligji;
1.37. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesit ose importuesit nuk mbajnë evidencë për kimikatet e rrezikshme sipas nenit 48 të këtij ligji;
1.38. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi ose përdoruesi i kimikateve të rrezikshme nuk njofton Ministrinë për përdorimin e emrit alternativ të substancës së rrezikshme që gjindet në përzierje, sipas paragrafit 2 të nenit 50 të këtij ligji;
1.39. tremijë (3.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i substancave, përzierjeve dhe produkteve nuk i përmbahet kufizimeve dhe ndalimit sipas dispozitave të nxjerra nga organi kompetent sipas nenit 51 dhe 52 të këtij ligji;
1.40. tremijë (3.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse vendosja e kimikateve të rrezikshme në treg bëhet nga personat të cilët nuk janë të pajisur me leje për qarkullimin e kimikateve, sipas paragrafit 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 53 të këtij ligji;
1.41. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse nuk i përmbushë kushtet themelore për ruajtjen e kimikateve të rrezikshme në një objekt të përgatitur për magazinimin e kimikateve, sipas paragrafit 5 të nenit 53 të këtij ligji;
1.42. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse poseduesi i lejes nuk i përmbahet kushteve për të cilat është lëshuar leja për qarkullimin e kimikateve sipas paragrafit 1,2, 3 dhe 4 të nenit 58 të këtij ligji;
1.43. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse poseduesi i lejes për qarkullimin e kimikateve të rrezikshme nuk mbanë evidencëm për kimikatet e rrezikshëme dhe nuk raporton në MMPH, sipas paragrafit 1 të nenit 59 të këtij ligji;
1.44. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse substancat dhe përzierjet e rrezikshme nuk mbahen dhe ruhen mirë në përputhje me llojin e rrezikut që mund të shkaktohet nga ndikimet e jashtme, nga palët e pa autorizuara, apo të shkaktoj konfuzion për ngjashmëri me mallrat e konsumit të përgjithshëm, veçanërisht me ushqime sipas paragrafit 1 të nenit 60 të këtij ligji;

1.45. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse substancat dhe përzierjet e rrezikshme nuk janë qartësisht të identifikueshme që gjatë ruajtjes në magazina nuk mbahen të ndara nga mallrat e tjera sipas paragrafit 4 të nenit 60 të këtij ligji;
1.46. pesëqind (500) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse substancat dhe përzierjet e rrezikshme të cilat janë të furnizuara ruhet në enë ose paketime që shkaktojnë huti për shkak të ngjashmërisë me paketimet e produkteve ushqimore, kozmetike, produktet terapeutike ose ushqimin e kafshëve sipas paragrafit 7 të nenit 60 të këtij ligji;
1.47. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse eksportuesit dhe importuesit e kimikateve ose përzierjeve nga nenet 63,64 dhe 65 të këtij ligji nuk dërgojnë në Ministri të dhënat me kohë për sasitë e eksportuara dhe importuara të kimikateve dhe përzierjeve të caktuara, për shtetet nga të cilat janë importuar ose eksportuar dhe shënimet për eksportuesin dhe importuesin e kimikateve sipas paragrafit 1, 2 dhe 4 të nenit 65 të këtij ligji;
1.48. njëmijë (1.000) deri në tremijë (3.000) Euro, nëse eksportuesi i kimikateve dhe përzierjeve nuk i dërgon informatat në Ministri, për nevojat e organit kompetent të shtetit nëpër teritorin e të cilit zhvillohet tranziti i substancave dhe përzierjeve në kohën e caktuar sipas paragrafit 1 të nenit 66 të këtij ligji;
1.49. njëzetëmijë (20.000) deri në tridhjetëmijë (30.000) Euro, nëse personat që importojnë dhe eksportojnë substancat dhe përzierjet, përdorimi i të cilave është i ndaluar me qëllim për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 67 të këtij ligji;
1.50. shtatëmijë (7.000) deri në njëzetëmijë (20.000) Euro, nëse eksportohen kimikatet e rrezikshme që afati i përdorimit iu skadon 6 muaj pasi të eksportohen apo importohen sipas paragrafit 3 të nenit 67 të këtij ligji;
1.51. pesëmijë (5.000) deri në tetëmijë (8.000) Euro, nëse prodhuesi dhe importuesi i detergjenteve nuk nxjerr Leje para se të vendosë në treg detergjentin që plotëson kushtet nga paragrafi 1 të nenit 69 dhe sipas paragrafit 1 të nenit 70 të këtij ligji;
1.52. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse nuk e tërheq nga tregu në afatin e caktuar detergjentin apo substancen tension-aktive për të cilin do të kërkohet ndalimi i përdorimit sipas paragrafit 2 të nenit 70 të këtij ligji;
1.53. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse bartësi i Lejes nuk iu përmbahet kushteve për të cilat është lëshuar Leja për vendosjen e detergjenteve në treg sipas paragrafit 4 të nenit 71 të këtij ligji;
1.54. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse prodhuesi i detergjenteve nuk i ruan rezultatet nga shqyrtimet e kryera në laborator sipas paragrafit 1 të nenit 74 të këtij ligji;
1.55. pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse prodhuesi i detergjenteve nuk mbanë Regjistrin e komponentave që përmban detergjenti i caktuar dhe nuk i ruan shënimet për kohë të caktuar si dhe nuk i bënë ato publike sipas paragrafit 3 të nenit 74 të këtij ligji;
1.56. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse prodhuesi, importuesi dhe përdoruesi i kimikateve të rrezikshme nuk e emëron /siguron personin professional për kimikate për mes kontratës, të siguroj një person fizik ose juridik përgjegjës për të dhënë këshilla lidhur me rregullat ligjore dhe standardet teknike për menaxhimin e kimikateve sipas paragrafit 1 dhe 2 të nenit 78 të këtij ligji;
1.57. dymijë (2.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, nëse personin profesional për kimikate nuk posedon kualifikimin e nivelit univerzitar të degëve dhe të fushave të caktuara sipas paragrafit 3 të nenit 78 të këtij ligji; 1.58. tremijë (3.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro, nëse personat fizik dhe juridik nuk i mundësojnë inspektorit mbikëqyrjen pa pengesa për marrjen e shënimeve dhe informatave të duhura apo kërkuara dhe mostrave sipas paragrafit 1 të nenit 81 dhe nenit 87 të këtij ligji.

2. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, do të ndëshkohet me gjobë në vlerë prej njëqind (100) deri në njëmijë euro (1.000 €) edhe personi përgjegjës i personit juridik.
3. Personat që shkelin parimin e konfidencialitetit, nga paragrafi 6 neni 49 i këtij ligji edhe pasi t'iu ketë mbaruar punësimi, do të gjobitet për kundërvajtje në vlerë prej njëqindë (100) deri në njëmijë (1.000) Euro.
4. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, personit juridik, përkrah denimit në të holla me qëllim të marrjes së masave për siguri nga kimikatet, mund ti ndalohet edhe veprimtaria deri në pesë (5) vite.
5. Për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, me qëllim të marrjes së masave për siguri nga kimikatet, personit përgjegjës i personit juridik i ndalohet veprimtaria deri në dhjetë (10) vite.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 34

Mbikëqyrja inspektuese
Ministria nëpërmjet inspektoratit të mbrojtjes së mjedisit është përgjegjëse për të gjitha inspektimet e projektit dhe zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 38

Ndëshkimet për shkeljet e këtij ligji
1. Të gjithë personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji ose me aktet e nxjerra në bazë të këtij ligji, do të dënohet për kundërvajtje, dhe atë personi fizik prej njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro, ndërsa personi juridik prej dhjetëmijë (10.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, nëse:
1.1. realizimi i projektit të planifikuar është nisur pa kryerjen e VNM-së dhe sigurimin e Vendimit për Pëlqim Mjedisor sipas paragrafit 1. të nenit 7 të këtij ligji;
1.2. jepen të dhëna, deklarata të pavërteta, falsifikim i dokumenteve ose informata të rreme dhe dezinformuese gjatë të gjitha fazave të procedurës së VNM-së sipas nenit paragrafit 4. të nenit 16 të këtij ligji.
1.3. aplikuesi nuk përmbushë obligimet për masat mbrojtëse, të parapara në Raportin e VNM-së dhe kushtet e caktuara në Vendimin për Pëlqim Mjedisor sipas paragrafit 1. të nenit 32 të këtij ligji.
2. Hartuesi i raportit të VNM, i cili jep të dhëna, deklarata të pavërteta dhe informata të rreme, i merret licenca, për hartimin e raporteve të VNM. 3. Me gjobë prej dhjetëmijë (10.000) deri në gjashtëdhjetëmijë (60.000) Euro, dënohen personat të cilët edhe pas gjobitjes nga paragrafi 1 i këtij neni nuk kanë përmbush kushtet nga paragrafi 1. i nenit 7, paragrafi 4. i nenit 16 dhe sipas paragrafit 1. të nenit 32 të këtij ligji. 4. Nëse aplikuesi edhe pas gjobitjes nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni nuk përmbush kushtet, do të veprohet sipas paragrafit 3. të nenit 32 të këtij ligji.

Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi Jo-jonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 50

1. Mbikëqyrjen për zbatimin e këtij ligji e bën Inspektorati gjegjës dhe inspektoratet e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Transportit, MEM, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 54

Veprat penale
1. Secili që mbledh, përpunon, deponon apo vendosë materialin radioaktiv kundër mënyrës së parashikuar dhe kushteve të parapara, do të dënohet për vepër penale me burg prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.
2. Secili që importon, përpunon, deponon ose vendosë material radioaktiv, mbeturinë me prejardhje të huaj në territorin e Kosovës, do të dënohet për vepër penale me burg prej gjashtë (6) muajsh deri në pesë (5) vjet.

Neni 55
Kundërvajtjet

1. Personi juridik, për kundërvajtje, do të gjobitet me të holla në shumë prej dymijë (2.000) deri në njëzetmijë (20.000) Euro, nëse:
1.1. gjatë punës me burimet e rrezatimit jonizues shkakton kontaminimin e mjedisit mbi VK ose nuk e kryen dekontaminimin në mënyrë të paraparë, nuk lajmëron me kohë organin kompetent të qeverisë (paragrafi. 1 i nenit 22 të këtij ligji);
1.2. vë në qarkullim ujin e pijes, artikujt ushqimorë, ushqimin e kafshëve dhe gjërat e përdorimit të përgjithshëm të cilat përmbajnë radionukleide mbi VK (neni 31 i këtij ligji);
1.3. grumbullon, përpunon, deponon ose vendosë mbeturinë radioaktive në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
1.4. vepron kundër mënyrës së paraparë dhe kushteve të parapara (paragrafi 1. i nenit 25 të këtij ligji);
1.5. importon mbeturinë radioaktive me prejardhje jashtë vendit ose e përpunon, deponon dhe vendos në territorin e Kosovës (paragrafi 2. i nenit 29 të këtij ligji);
1.6. nuk organizon ose nuk e zbaton mbrojtjen fizike të objektit nuklear, materialit nuklear ose mbeturinës radioaktive, nuk e sjellë aktin e përgjithshëm për masat të mbrojtjes fizike të objektit nuklear, materialit nuklear dhe mbeturinës radioaktive (neni 33 i këtij ligji).
2. Për punët nga paragrafi 1, i këtij neni, për kundërvajtje gjobitet me të holla në shumë prej pesëdhjetë (50) deri dyqind (200) Euro, personi përgjegjës juridik.

Neni 56

1. Me të holla në shumë prej pesëqind (500) deri në pesëmijë (5.000) Euro, do të gjobitet, shfrytëzuesi i objektit nuklear, nëse në emër të sigurimit për mbulimin e përgjegjësisë së vetë për dëm nuklear, nuk ka deponuar shumën prej njëqindmijë (100.000) Eurosh.
2. Për punët nga paragrafi 1 i këtij neni, me të holla, në shumë prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro, do të gjobitet edhe personi përgjegjës i shfrytëzimit të stabilimentit nuklear.

Neni 57

1. Me të holla prej pesëqind (500) deri në katërmijë (4.000) Euro, do të dënohet personi juridik, nëse:
1.1. nuk bën analizën sistematike të përbërjes së radionukleideve në mjedis ose nuk bën matjen e pandërprerë të dozës së absorbuar të rrezatimit, në mënyrë të paraparë dhe sipas kushteve të parapara.
1.2. nuk përmbush kushtet e parapara për prodhim, qarkullim dhe shfrytëzim të burimeve të rrezatimit jonizues ose prodhon, bënë bartjen dhe shfrytëzon burimet e rrezatimit jonizues para marrjes së vendimit nga Ministria ose këtë vendim gjatë regjistrimit në regjistër, nuk ia dorëzon organit kompetent (neni 18 i këtij ligji);
1.3. personave të punësuar në vendet me ekspozim të rrezatimit jonizues nuk ua siguron kontrollin dozimetrik, nuk i pajisë me mjete mbrojtëse personale, nuk i udhëzon për kontrollim të rregullt mjekësor ose nuk ua siguron vërtetimin e rregullsisë së atyre mjeteve dhe shfrytëzimin e tyre (neni 13 i këtij ligji);
1.4. bën bartjen e burimeve të rrezatimit jonizues jashtë kufijve të Kosovës pa lejen e organit kompetent, ose bën bartjen e burimit të rrezatimit jonizues në zonat kufitare ku nuk është e organizuar mbikëqyrja inspektuese apo nuk informon me kohë inspektorin për arritjen e dërgesës së burimit të rrezatimit jonizues në zonën kufitare (neni 30 i këtij ligji);
1.5. nuk zbaton masat e sigurisë nukleare, të parapara me ligj;
1.6. i qaset ndërtimit, lëshon në punë provuese, lëshon në punë ose përgjithmonë ndërpret punën e objektit nuklear pa lejen e organit kompetent (neni 31 i këtij ligji);
1.7. për kryerjen e detyrave dhe punëve të udhëheqjes së prodhimit në objektin nuklear ose në detyrat dhe punët e mbikëqyrjes së atij procesi, cakton persona të cilët nuk i përmbushin kushtet e parapara;
1.8. nuk bën analizën sistematike të prezencës së radionukleideve në mjedis, në rrethin e vetë në mënyrë adekuate sipas kushteve të parapara;
1.9. nëse me rastin e ndërprerjes së shfrytëzimit përfundimtar të objektit nuklear, paraprakisht për këtë, nuk informon organin kompetent të qeverisë, apo gjatë ndërprerjes së përhershme të shfrytëzimit të objektit, në afatin që ia cakton organi kompetent, nuk zbaton masat gjegjëse të sanimit në lokacion, objekt si dhe në rrethinë;

1.10. nuk mban evidencën e paraparë sipas zonave të bilanceve për materialet nukleare të cilat i prodhon, përpunon, shfrytëzon, apo deponon ose të dhënat nga kjo evidencë, nuk ia dërgon organit kompetent, nuk vepron sipas vendimit ekzekutiv të organit kompetent me të cilën përcaktohet një prej masave të parapara;
1.11. inspektorit, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, nuk i mundëson punë pa pengesa dhe qasje në dokumentacion si dhe materialet tjera të duhura.

2. Për moskryerjen e punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, do të gjobitet me të holla prej njëqind (100) deri treqind (300) Euro edhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 58
1. Me të holla në shumë prej treqind (300) deri nëntëqind (900) Euro do të gjobitet personi fizik, ndërsa personi juridik prej njëmijë (1000) deri në tremijë (3000) nëse:
1.1. raportin vjetor të analizës sistematike të përmbajtjeve radionukleide nuk ia dorëzon organit kompetent në afatin e paraparë dhe në rast të situatës së jashtëzakonshme, nuk informon menjëherë Ministrinë;
1.2. nuk mban evidencën e paraparë, nuk e informon MMPH-në për burimet e rrezatimit jonizues dhe jo-jonizues, të cilat i prodhon, i bartë apo i shfrytëzon, ose për çdo kërkesë apo dërgesë të burimit të rrezatimit jonizues;
1.3. nuk bën matjen e shkallës së ekspozimit në rrezatim jonizues të personave që punojnë me burimet e rrezatimit jonizues, pacientëve dhe popullatës apo gjatë asaj matjeje nuk mban evidencën e paraparë për rrezatimin e popullatës, pacientëve ose personave të cilët gjatë punës i janë ekspozuar ndikimit të rrezatimit jonizues apo nëse raportin për rrezatim nuk ia dërgon organit kompetent;
1.4. në vendin e ekspozimit me rrezatim jonizues, punëson apo mban në punë personin i cili nuk ka përgatitje profesionale të paraparë apo nuk i përmbush kushtet shëndetësore të parapara për punë në burimet e rrezatimit jonizues;
1.5. personi i cili punon në burimin e rrezatimit jonizues, nuk vihet nën mbikëqyrjen shëndetësore;
1.6. pranon në punë në burimet e rrezatimit jonizues personin të cilit në bazë të këtij ligji, i është ndaluar të punojë me ato burime;
1.7. nuk zbaton, në mënyrë të paraparë, programin e masave dhe kontrollin e cilësisë së masave mbrojtëse nga rrezatimi jonizues.

Neni 59
Me të holla prej njëqind (100) deri pesëqind (500) Euro, do të gjobitet personi i cili punon në burimet e rrezatimit jonizues, nëse gjatë kësaj pune nuk i nënshtrohet kontrollit të rregullt në afat të paraparë me ligj ose nëse nuk përdor mjetet personale dhe mjetet e tjera për mbrojtjen nga rrezatimi jonizues .

Ligji për Produkte Biocide

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 54

Organet kompetente për mbikëqyrjen e PB
1. Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerra nga ky ligj, informimin dhe shkëmbimin e informatave e bënë Ministria .
2. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore që dalin nga ky ligj e bëjnë inspektoratet: mjedisorë, sanitarë dhe fitosanitar.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 58

Gjobat
1. Dënohet për kundërvajtje, me gjobë prej pesëmijë (5000) deri pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, personi juridik nëse:

1.1. shfrytëzuesi i PB i cili i përdorë në kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të këtij ligji;
1.2. vendosë në treg apo përdorë substanca aktive apo substanca bazike në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji;
1.3. PB vendoset ne treg ose përdorët në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 të këtij
1.4. sipas kërkesës së Ministrisë nuk i ofron mostrat e PB dhe përbërjen e tyre sipas nenit 15 paragrafi 4 të këtij ligji;
1.5. vendosën në treg dhe përdorën PB si mall për konsum të përgjithshëm neni 18 paragrafi 1 të këtij ligji;
1.6. bartësi i lejes për hulumtime shkencore dhe zhvillim, i përdorë PB në sipërfaqe dhe sasi të ndryshme nga ato të lejuara, bënë hulumtimet nën kushtet tjera nga ato të lejuara sipas nenit 31 paragrafi 3. të këtij ligji nëse nuk mbanë evidencën me shkrim, nuk mban shënimet, për sasinë e furnizuar, emrat dhe adresat e personave që e pranojnë PB për mundësinë e ndikimeve në shëndet dhe mjedis respektivisht nëse nuk I prezanton shënimet me shkrim në Ministri, dokumentacionin dhe njoftimin lidhur me zhvillimin e hulumtimit dhe rezultateve të hulumtimit neni 31 paragrafi 5. i këtij ligji.
1.7. PB vendoset ne treg ose përdorët në kundërshtim me dispozitat e nenit 32, 33, 34, dhe 35, të këtij ligji .
1.8. PB paketohet dhe deklarohet në kundërshtim me dispozitat nga neni 36 i këtij ligji.
1.9. PB i klasifikuar si i rrezikshëm, është shënjuar më pak i rrezikshëm ose I parrezikshëm për shëndetin e njeriut, shtazëve dhe mjedisin ose shënohet me fjalë të cilat krijojnë hezitim pasiguri dhe huti te përdoruesi neni 37 paragrafi 1. dhe 2.
respektivisht nëse paketon PB në at mënyrë që të krijon dilema për shfrytëzuesin neni 37 paragrafi 3. i këtij ligji .
1.10. nuk e jep në dispozicion Listën teknike të sigurisë, të gjithë shfrytëzuesve profesional të PB dhe sipas nevojës edhe përdoruesve të PB të tjerë me kërkesën e tyre neni 38 paragrafi 2. të këtij ligji .
1.11. e shpallë PB në kundërshtim me dispozitat e nenit 39 të këtij ligji.
1.12. nuk i përcjell dhe vëzhgon të gjitha efektet dhe njohuritë e reja për PB, i cilën mund të ketë ndikime të dëmshme në shëndetin e njeriut, kafshëve dhe mjedis neni 36 paragrafi 1. i këtij ligji dhe nëse me kohë nuk e lajmëron Ministrinë për të gjitha shënimet që i ka në dijeni ose për të cilat supozon se mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e lejes së dhënë apo për lëshimin e lejes neni 40 paragrafi 2. të këtij ligji.
1.13. nuk mban evidencë në pajtim me aktet ligjore të veçanta me të cilat rregullohen kimikatet e rrezikshme shënimet në Ministri deri më 31 Mars të vitit vijues kalendarin për vitin paraprak kalendarik neni 37 paragrafi 2. i këtij ligji.
1.14. vepron në kundërshtim me nenin 42 paragrafin 3. dhe 4. të këtij ligji.
1.15. nuk siguron kushtet të cilat pengojnë apo reduktojnë rrezikun për shëndetin e njeriut, kafshëve dhe mjedisin neni 48 i këtij ligji.
1.16. dokumentacionin për PB, nuk e ruan siç është përcaktuar sipas nenit 47 të këtij ligji.
1.17. vepron në kundërshtim me nenin 49 të këtij ligji.
1.18. vepron në kundërshtim me ndalesën, respektivisht kufizimet për prodhim apo vendosjen në treg të PB, neni 50 të këtij ligji.
1.19. importon PB në kundërshtim me nenin 53 të këtij ligji.
1.20. vepron në kundërshtim me nenin 55 paragrafin 2. të këtij ligji.

2. Dënohet për kundërvajtje me dënim me gjobë prej njëmijë (1000) deri dhjetëmijë (10000) Euro, nga paragrafi 1. i këtij neni personi përgjegjës i personit juridik.
3. Personi fizik dënohet për kundërvajtje me gjobë prej njëmijë (1000) deri pesëmijë (5.000) Euro për shkelje nga paragrafi 1. pikat 1. 2.3. 4. 5. 10. 11. 12. 13. 14. 15. 16. 17. dhe 19. Të këtij neni.
4. Për tentim të shkeljes nga paragrafi 1. pikat 1. 2. 3. 5. 6. 7. 8.10. 16. 17. dhe 18. të këtij neni do të dënohet për kundërvajtje me gjobë njëmijë (1000) Euro.

Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 22

22.1. Mbikëqyrjen, për aplikimin e këtij ligji dhe të akteve plotësuese normative që dalin nga ky ligj, e kryejnë inspektorët e mjedisit dhe planifikimit hapësinor dhe inspektorët komunal të mjedisit.

22.2. Mbikëqyrja për dispozitat e këtij ligji të cilat i dedikohen zhurmës në hapësira ku punohet, ku gjatë procesit të punës shkaktohet zhurmë si dhe në dispozitat e këtij ligji të cilat i dedikohen qarkullimit të makinave, mjeteve transportuese, pajisjeve dhe aparateve, fuqisë së zërimit që emitohet nga to, në kushte të përcaktuara, kryhet nga inspektoret e inspektoratit të mjedisit.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 25

25.1. Me gjobë në vlerë prej 500 – 10.000 €, do të gjobitet për kundërvajtje personi juridik nëse:
a) Shkakton që niveli i zhurmës së cilës i eksponohen njerëzit në mjediset ku jetojnë, t'i tejkaloj kufijtë e lejuar në nenin 2 të këtij ligji;
b) Nuk lejon kryerjen e matjeve të zhurmës nga ana e personit të autorizuar zyrtar sipas nenit 4 të këtij ligji;
c) Përdoren makinat, mjetet transportuese, pajisjet dhe aparatet në qarkullim, respektivisht në përdorim, pa shenime mbi forcën e zërit sipas nenit 7 të këtij ligji;
d) Fillon kryerjen e veprimitarisë ose aktiviteteve të tjera, pa vendim të organit kompetent, me të cilin përcaktohet se janë kryer teë gjitha masat për mbrojtje nga zhurma;
e) Shfrytëzon burimet e zhurmës në vende të hapura, pa vendim të organit kompetent sipas nenit 13 të këtij ligji;
f) Kryen punime, veprime dhe aktivitete tjera, me të cilat pengon qetësinë dhe pushimin e njerëzve në hapsirë të mbyllur ose të hapur në vendet ku ata jetojnë;
g) Matjet i kryen personi i cili nuk e ka të dhenë provimin professional;
h) Matja e zhurmës, llogaritja dhe vlerësimi nuk kryhen sipas nenit 20 të këtij ligji;
i) Të dhënat nga matjet e zhurmës nuk janë në përputhje me nenin 20 të këtij ligji;
j) Nuk ndërmerr masa nga rregullorja ose nga urdhërat për mbrojtje nga zhurma sipas nenit 23 të këtij ligji.

25.2. Për shkeljet nga paragrafi 1 i këtij neni, gjobitet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës i personit juridik, me gjobë në vlerë prej 100 – 1000 €.

Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 34

Mbikëqyrja inspektive
1. Gjatë mbikëqyrjes inspektive për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, me shfrytëzim edhe të laboratorëve mobil, inspektori rregullisht mbikëqyrë:
1.1. zbatimin e masave mbrojtëse të definuara në procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
1.2. punën e pajisjeve të repartit dhe pajisjeve mbrojtëse në burimet e ndotjes;
1.3. përmbushjen e VKE dhe zbatimin e masave mbrojtëse;
1.4. zbatimin e matjeve të emisionit dhe hartimin e raportit;
1.5. zbatimin e programeve sanuese dhe programeve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit; 1.6. zbatimin e masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 38

1. Me gjobë në të holla në lartësi prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) deri në pesëdhjetë mijë (50.000) euro dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
1.1. prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit, tregtarët dhe përdoruesit komercial të pajisjeve, prodhimeve, materialeve dhe substancave që ndotin ajrin, nuk i përmbahen legjislacionit vendor. (neni 4 paragrafi 2. i këtij ligji);
1.2. nuk i zbaton standardet (neni 7 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.3. djeg lëndët në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2. i këtij ligji;

1.4. nuk i përmbushë detyrimet nga neni 9 i këtij ligji;
1.5. lejon tejkalimin e përkohshëm të VKE më tepër se gjashtë (6) muaj dhe dy herë më të larta se VKE (neni 10 paragrafi 3. i këtij ligji); 1.6. nuk i përmbahet detyrimeve nga neni 12 i këtij ligji;
1.7. nuk prodhon dhe importon mjete dhe pajisje që i plotësojnë normat e shkarkimeve në ajër (neni 13 paragrafi 2 i këtij ligji);
1.8. shfrytëzon vajrat e rënda si lëndë djegëse (neni 16. paragrafi 1. i këtij ligji);
1.9. nuk i përmbahet detyrimeve nga neni 17 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.10. nuk i përmbahet detyrimeve nga akti i veçantë nënligjor nga neni 18 i këtij ligji,
1.11. nuk i përmbahet detyrimeve nga akti i veçantë nënligjor nga neni 19 paragrafi 2. i këtij ligji;
1.12. nuk i përmbahet detyrimeve nga akti i veçantë nënligjor nga neni 20 paragrafi 5. i këtij ligji;
1.13. nuk i raportojnë Ministrisë të dhënat për ndotjen e ajrit (neni 22 paragrafi 1 i këtij ligji);
1.14. nuk zhvillon dhe aplikon masa preventive për përmirësimin e cilësisë së ajrit (neni 23 paragrafi 3. i këtij ligji);
1.15. nuk informon në mënyrë periodike Ministrinë, publikun dhe autoritetet lokale për masat preventive (neni 23 paragrafi 4. i këtij ligji); 1.16. nuk zhvillon dhe ndërmerr masa preventive (neni 24 paragrafi 7. i këtij ligji);
1.17. nuk ndërmerr masa emergjente për normalizimin e gjendjes së cilësisë së ajrit (neni 24 paragrafi 8. i këtij ligji);

2. Me gjobë në të holla në lartësi prej pesëqind (500) deri në dy mijë (2.000) Euro dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 39
1. Me gjobë në të holla në lartësi prej tre mijë (3.000) deri në dhjetë mijë (10.000) Euro dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:
1.1. nuk ruan cilësinë e ajrit dhe nuk e mbron atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtron në territorin e Republikës së Kosovës (neni 8 paragrafi 1.2 dhe 1.3 i këtij ligji);
1.2. nuk i përmbahen detyrimeve nga neni 13 paragrafi 1 i këtij ligji; 1.3. nuk i përmbahen detyrimeve nga akti i veçantë nënligjor sipas nenit 14 paragrafi 2. i këtij ligji;
2. Me gjobë në të holla në lartësi prej treqind (300) deri në një mijë (1.000) Euro dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Legjislacioni i ujërave

Në vijim do të paraqiten dispozitat e legjislacionit të ujërave që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektive dhe dispozitat ndëshkuese. Varësisht nga lloji i kundërvajtjes, inspektorët së bashku me zyrtarët ligjorë të MMPH-së përgadisin aktet ligjore sipas këtyre dispozitave materiale dhe dispozitave procedurale të paraqitura më poshtë.

Ligji për Ujërat e Kosovës

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 94

Mbikëqyrja inspektuese

1. Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji i kryejnë Inspektorët e ujërave të Ministrisë dhe inspektorët e autorizuar të ujërave të komunave.
2. Inspektori i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivel të Kosovës, ndërsa inspektori i autorizuar i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivele komunale.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 111

1. Të gjithë personat të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji apo dispozitat e nxjerra nga ky ligj, do të konsiderohen si kundervajtje dhe do të gjobitet prej pesëmijë (5000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
2. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 10, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëmijë (5000 €) deri në dhjetë mijë (10.000 €), ndërsa personi juridik prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në tridhjetë mijë (30.000 €) euro.
3. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 11, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në njëzet mijë (20.000 €) euro, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
4. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 42 të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në në tridhjetë mijë (30.000 €) euro, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në tetëdhjetë mijë (80.000 €) euro.
5. Personi juridik i cili vepron në kundërshtim me nenin 43, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
6. Personi juridik i cili vepron në kundërshtim me nenin 44, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
7. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 47, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në dyzet mijë (40.000 €) , ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
8. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji, do të gjobitet prej pesë mijë (5.000 €) deri në dhjetë mijë (10.000 €) euro, ndërsa personi juridik prej dhjetë mijë (10.000 €) deri tridhjetë mijë (30.000 €) euro.
9. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji, do të gjobitet prej pesë mijë (5.000 €) deri në njëzet mijë (20.000 €), ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro
10. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 61, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në dyzet mijë (40.000 €), ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
11. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 62, të këtij ligji, do të gjobitet prej pesëmijë (5.000 €) deri në 30.000 €, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në shtatëdhjetë mijë (70.000 €) euro.
12. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 63, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në pesëdhjetë mijë (50.000) ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
13. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 64, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në 30.000 €, ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
14. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 69, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në tridhjetë mijë (30.000 €), ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000€) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
15. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 72, të këtij ligji, do të gjobitet prej dhjetë mijë (10.000 €) deri në pesëdhjetë mijë (50.000) ndërsa personi juridik prej pesëdhjetë mijë (50.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.
16. Personi fizik i cili vepron në kundërshtim me nenin 86, të këtij ligji, do të gjobitet prej njëmijë (1000 €) deri në dhjetë mijë (10.000 €) euro , ndërsa personi juridik prej tridhjetë mijë (30.000 €) deri në njëqind mijë (100.000 €) euro.

Legjislacioni i ndërtimit

Në vijim do të paraqiten dispozitat e legjislacionit të ndërtimit që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektive dhe dispozitat ndëshkuese. Varësisht nga lloji i kundërvajtjes,

inspektorët së bashku me zyrtarët ligjorë të MMPH-së përgadisin aktet ligjore sipas këtyre dispozitave materiale dhe dispozitave procedurale të paraqitura më poshtë.

Ligji për Ndërtim

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 29

Mbikëqyrja inspektuese
Funksionin e inspektimit të paraparë me këtë ligj dhe akte tjera nënligjore e kryen Inspekcioni Ndërtimor i Ministrisë dhe Inspekcioni Ndërtimor i Komunave brenda kompetencave të tyre.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 35
Kundërvajtjet nga pronari

1. Mënyra, procedurat, ekzekutimi dhe shumat e gjobave ndaj pjesëmarrësve në ndërtim përcaktohen nga Ministria me akt të veçante administrativ dhe rishikohet dhe miratohen për çdo vit dhe publikohen në Gazetën zyrtare.
2. Poseduesi i lejes ndërtimore do të gjobitet nëse:
2.1. puna ndërtimore krijon rrezik për personat tjerë, dhe nëse nuk siguron, rrethon ose shënjon dukshëm me shenja treguese rreziqet që mund t'u kanosen kalimtarëve;
2.2. nuk vendos në vendndërtim tabelën informuese, apo
2.3. nuk ndërmerr masa për sigurimin e ndërtimit dhe ndërtimeve fqinje.

Neni 36
Kundërvajtjet nga organet kompetente

Të gjithë punonjësit përgjegjës dhe Inspektorët në organet kompetente që veprojnë në kundërshtim me këtë ligj si dhe për shkeljet e evidentuara procedurale sipas këtij ligji do të merren masa ndëshkuese financiare dhe penale sipas Kodit Penal të Kosovës.

Legjislacioni i banimit

Në vijim do të paraqiten dispozitat e legjislacionit të banimit që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektive dhe dispozitat ndëshkuese. Varësisht nga lloji i kundërvajtjes, inspektorët së bashku me zyrtarët ligjorë të MMPH-së përgadisin aktet ligjore sipas këtyre dispozitave materiale dhe dispozitave procedurale të paraqitura më poshtë.

Ligji për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi

Dispozitat mbikëqyrëse

Neni 45

Mbikëqyrja inspektuese

1. Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe akteve nënligjore të nxjerrura në bazë të këtij ligji, e kryen inspektori komunal i autorizuar për banim në kuadër të organit kompetent për inspektim.
2. Në territoret që janë nën kompetencën e Ministrisë, mbikëqyrjen inspektuese e bënë Inspektorati i Ministrisë.

3. Gjatë kryerjes së punës inspektuese, inspektorët nga paragrafi 1. i këtij neni kanë të drejtë të kryejnë mbikëqyrje në të gjitha ndërtesat për banim
4. Shoqata e pronarëve ose Administratori si dhe pronarët e njësive individuale në ndërtesën në bashkëpronësi ose përfaqësuesve të tyre janë të detyruar t'i mundësojnë inspektorëve qasje në dokumentet e nevojshme lidhur me administrimin e ndërtesës në bashkëpronësi.
5. Për gjendjen e konstatuar inspektori mban procesverbal në bazë të cilit nxjerr aktvendim dhe në bazë të cilit konkluzion lejohet ekzekutimi.
6. Kundër aktvendimit të inspektorit të autorizuar për banim mund të bëhet ankesë në Ministri.
7. Ankesa kundër aktvendimit nuk e shtyen e ekzekutimin.

Dispozitat ndëshkuese

1. Shoqata e Pronarëve mund të regjistrojë një barrë pagese ndaj një njësie për çdo pagesë të vonuar ndaj saj ose gjoba të vendosura ndaj pronarit të asaj njësie.
2. Shuma e barrës së pagesës rritet varësisht me vonesën e pagesës.
3. Barra e pagesës do të mbetet mbi njësinë dhe duhet të përmbushet para se njësia të mund të shitet, transferohet ose bartet në ndonjë mënyrë tjetër.
4. Një barrë pagese sipas këtij neni është me përparësi ndaj të gjitha barrë pagesave tjera mbi një njësi, përveç:
4.1. barrës së pagesave të regjistruara para regjistrimit të marrëveshjes së bashkëpronësisë;
4.2. interesit të sigurimit në njësinë që ka prioritet ndaj të gjitha interesave tjera të sigurimit dhe që është regjistruar para datës në të cilën evidentohet se taksa e kërkuar nuk është paguar; dhe
4.3. barrës tatimore për patundshmëri dhe taksat apo ngarkesat tjera qeveritare ndaj njësisë.
5. Barra e pagesës regjistrohet në marrëveshjen e bashkëpronësisë dhe përbën njoftim dhe për kryerje të saj.
6. Shoqata do t'i ofrojë pronarit të njësisë apo përfaqësuesit të caktuar të pronarit të njësisë një njoftim me shkrim për natyrën dhe shumën e papaguar të taksave, gjobave ose shumave tjera që aktualisht ngarkohen ndaj njësisë së pronarit. Nëse nuk jepet njoftim, shoqata nuk do të ketë të drejtë të shpall barrë pagese mbi njësinë.
7. Barra e pagesës e shoqatës mund të ekzekutohet në mënyrë të njëjtë si hipoteka në patundshmëri.
8. Shoqata do të ketë të drejtë në shpenzimet dhe tarifat e arsyeshme të avokatit që i dalin shoqatës për të zbatuar barrën e pagesës.
9. Anëtarët e Kryesisë së Shoqatës ose Administratorët i nënshtrohen detyrimeve ligjore ndaj Shoqatës së Pronarëve siç parashihet me këtë ligj dhe gjithashtu mund të ballafaqohen me ndjekje penale nëse përfshihen në veprimtari kriminale gjatë kryerjes së përgjegjësive të tyre.